



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 139

Tiranë – E mërkurë, 27 korrik 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 523, datë 13.7.2016	Për përcaktimin e kriterëve të tregimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese..... 11153
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 15, datë 19.7.2016	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 19, datë 1.9.2011, “Për modalitetet e aplikimit të pullave të akcizës dhe pullave fiskale në produktet e duhanit, birrës dhe alkoolit”, të ndryshuar..... 11173
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 112, datë 8.7.2016	Për përcaktimin e të licencuarit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal për tregun e energjisë elektrike dhe përcaktimin e kushteve për ushtrimin e detyrimit të shërbimit universal..... 11178
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 113, datë 8.7.2016	Mbi miratimin e rregullores për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike..... 11179
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 114, datë 8.7.2016	Për miratimin e rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror..... 11183
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 115, datë 8.7.2016	Mbi përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike..... 11189
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 116, datë 8.7.2016	Mbi kërkesën e Shoqatës Shqiptare të Energjisë së Rinovueshme për rishikimin e vendimit nr. 101, datë 23.6.2016 të Bordit të ERE-s “Mbi miratimin e disa ndryshimeve në modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. (FPSH) dhe Prodhuesve të Vegjël të Energjisë (PVE), miratuar me vendimin nr. 80, datë 23.10.2009, të ndryshuar” 11190

**VENDIM****Nr. 523, datë 13.7.2016****PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË
TREGTIMIT E CERTIFIKIMIT TË
MATERIALEVE TË SHUMËZIMIT DHE
TË FIDANËVE TË BIMËVE
ZBUKURUESE¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 9, 14, pika 3, dhe 15, pika 3, të ligjit nr. 10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****I.1 Qëllimi dhe zbatimi**

1. Qëllimi i këtij vendimi është që të përcaktojë kërkesat në lidhje me prodhimin e tregtimit e materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese, kërkesat për furnizuesit, për paketimin dhe etiketimin, si dhe kërkesat e procedurat e kryerjes së certifikimit.

2. Ky vendim zbatohet për gjinitë dhe speciet e listuara në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe për hibridet dhe nënshartesat e tyre.

¹ Ky vendim është përafëruar pjesërisht me:

- Nr. CELEX: 01998L0056, nr. natyral: 98/56/EC, lloji i aktit: direktivë, institucioni që e ka miratuar: Këshilli Evropian, data e miratimit: 20 korrik 1998. Titulli i plotë: “Për tregtimin e materialit shumëzues të bimëve zbukuruese”. Numri i Fletores Zyrtare: L 226, e ndryshuar së fundi nga:

- Nr. CELEX: 32014R0652, nr. natyral: 652/2014, lloji i aktit: rregullore, institucioni që e ka miratuar: Parlamenti dhe Këshilli Evropian, data e miratimit: 15 maj 2014, titulli i plotë: që parashtron dispozitat për menaxhimin e shpenzimeve në lidhje me zinxhirin ushqimor, shëndetin dhe mbarëshkrimin e kafshëve, në lidhje me shëndetin e bimëve dhe materialit riprodhues bimor. Numri i Fletores Zyrtare: L 189.

- Nr. CELEX: 31993L0049, nr. natyral: 93/49/EEC, lloji i aktit: direktivë, institucioni që e ka miratuar: Komisioni Evropian, data e miratimit: 23 qershor 1993, titulli i plotë që përcakton programin i cili tregon kushtet që duhet të plotësohen nga materiali shumëzues i bimëve zbukuruese dhe nga bimët zbukuruese, në përputhje me direktivën e Këshillit 91/682/EEC. Numri i Fletores Zyrtare: L 250.

- Nr. CELEX: 31999L0066, nr. natyral: 99/66/EC, lloji i aktit: direktivë, institucioni që e ka miratuar: Komisioni Evropian, data e miratimit: 28 qershor 1999, titulli i plotë që përcakton kërkesat se si etiketa ose dokumentet e tjera përgatiten nga furnizuesi në përputhje me direktivën e Këshillit 98/56/EC. Numri i Fletores Zyrtare: L 164.

I.2 Përkufizime

Të gjithë termat e përcaktuar në ligjin nr. 10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë vendim, ndërsa termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

1. “Bimë zbukuruese”, bimët që kultivohen për pamjen e tyre tërheqëse dhe që shërbejnë për zbukurimin e kopshteve, mjediseve të banuara, për krijimin e peizazheve të projektuara dhe për lule të prera, për krijimin e buqetave.

2. “Material shumëzim”, materiali bimor i destinuar për shumëzimin e bimëve zbukuruese ose prodhimin e bimëve zbukuruese (fidanëve), të destinuara për tregtim të mëtejshëm, të tilla si:

a) farëra për prodhim fidanësh direkt ose për prodhim filizash për nënshartesa;

b) bulbe, qafë rrënje dhe zhardhokë, për prodhim bimësh direkt;

c) filiza dhe copa për nënshartesa;

ç) fundakë, kamza, lastunja dhe kalema për rrënjëzim, për prodhim fidanësh direkt;

d) kalema për shartim dhe sytha për shartim, si mbishartesë, për fidanë të shartuar;

dh) meristema rritje për shtim *in vitro*, për prodhim nënshartesash ose dhe mbishartesash, ose dhe fidanësh.

3. “Fidanë”, bimë zbukuruese, të prejardhura nga materialet e shumëzimit, të certifikuara sipas këtij vendimi, të cilët, pas tregtimit të tyre, destinohen për mbjellje ose rimbjellje në vendin e përhershëm.

4. “Bllok mëmë”, plantacioni i mbjellë me bimë zbukuruese shumëvjeçare, i destinuar për marrjen e materialit shumëzues që plotëson kërkesat e këtij vendimi.

5 “Parcelë për farë”, plantacioni i mbjellë me bimë zbukuruese njëvjeçare, që plotësojnë kërkesat e këtij vendimi, të destinuara për prodhim fare.

6. “Fidanishte”, vendi i prodhimit të materialeve të shumëzimit (përveç farës) dhe fidanëve të bimëve zbukuruese, që plotësojnë kërkesat e këtij vendimi për tregtim.

7. “Materiale shumëzim dhe fidanë të certifikuar”, materialet e shumëzimit dhe fidanët e pajisur me certifikatë zyrtare, që vërteton identitetin, pastërtinë varietore dhe pastërtinë fitosanitare nga organizmat dhe sëmundjet e dëmshëm, të listuar në aneksin 2 bashkëlidhur këtij vendimi.



8. “Shumëzim”, riprodhimi me mënyrë vegjetative ose mënyra të tjera, i bimëve zbukuruese.

9. “Ngarkesë”, sasia ose numri i njësive të materialeve të shumëzimit dhe fidanëve, të përbërë nga një ose më shumë lote, që transportohen së bashku.

10. “Numër i referencës së lotit” ose “numër i referencës së ngarkesës”, çdo shenjë numerike ose alfanumerike, e cila mundëson që lotet ose ngarkesat të dallohen dhe të gjurmohen.

11. “Organizmat e dëmshëm karantinorë”, organizmat që specifikohen në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e bimëve, futja dhe përhapja e të cilave ndalohet.

12. “Identitet varietor”, tërësia e veçorive botanike, morfologjike, biologjike dhe agroteknologjike që zotëron një varietet, vlera e të cilit është e njohur dhe plotëson qëllimet e përdorimit.

13. “Pastërti varietore”, kërkesa për gjendjen e materialeve të shumëzimit dhe fidanëve të bimëve zbukuruese pa përzierje me varietete e specie që nuk janë deklaruar në dokumentacionin përkatës ose dhe nuk janë shënuar si të tilla.

14. “Pastërti shëndetësore”, kërkesa për gjendjen e materialeve të shumëzimit dhe fidanëve të bimëve zbukuruese pa infeksione ose dhe pa simptoma të organizmave e të sëmundjeve të dëmshëm, të listuar në aneksin 2 të këtij vendimi dhe në legjislacionin për mbrojtjen e bimëve.

15. “Treguesit e cilësisë”, kërkesat që duhen plotësuar nga materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve zbukuruese në lidhje me cilësinë e anës pamore dhe zhvillimin e tyre, në funksion të përdorimit.

16. “Person përgjegjës i kualifikuar”, çdo person, fizik ose juridik, me profesion agronom ose inxhinier për mbarëshkrimin e pyjeve, me arsim të lartë, në cilësinë e furnizuesit ose i punësuar prej tij, dhe që ka aktpërfaqësimi nga furnizuesi për të vepruar në emër të tij për detyrimet që rrjedhin nga ligji nr. 10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, të ndryshuar.

II. KËRKESAT PËR TREGTIMIN E MATERIALEVE TË SHUMËZIMIT DHE FIDANËVE

1. Materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve zbukuruese mund të tregtohen, nëse:

a) u përkasin varieteteve ose hibrideve ndërvarietore apo, në rastin e nënshartësive, u përkasin specieve ose hibrideve ndërmjet specieve, të

regjistruara në katalogun kombëtar;

b) plotësojnë kërkesat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e bimëve dhe janë të pastër nga organizmat dhe sëmundjet e dëmshëm, të listuar, për çdo specie, në aneksin 2 bashkëngjitur këtij vendimi;

c) plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shkronjat “c”, “ç” dhe “d”, të pikës 2, të këtij kreu, për treguesit e cilësisë, identitetin dhe pastërtinë varietore;

ç) janë paketuar dhe etiketuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në aneksin 3, bashkëngjitur këtij vendimi;

d) janë pajisur me certifikatë fitosanitare, sipas modelit të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e bimëve dhe me certifikatë zyrtare, të lëshuar nga autoriteti certifikues, sipas modeleve 2 dhe 3, të aneksit 4, bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Kërkesat e mësipërme vlerësohen të plotësuara nëse, gjatë verifikimeve të kryera nga furnizuesi, në përputhje me planin e prodhimit dhe nga mbikëqyrjet e kryera nga inspektori fitosanitar e nga autoriteti certifikues, sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim, është vendosur se:

a) nga ana pamore, materialet e shumëzimit dhe fidanët janë të pastër nga organizmat dhe sëmundjet karantinorë ose ndonjë shenjë apo simptomë e tyre;

b) gjatë sezonit të rritjes, materialet e shumëzimit dhe/ose fidanët kanë rezultuar të pastër nga organizmat dhe sëmundjet e dëmshëm, që dëmtojnë cilësinë, të listuara në aneksin 2 të këtij vendimi;

c) në lidhje me treguesit e cilësisë, materialet e shumëzimit dhe/ose fidanët e bimëve zbukuruese, nga ana pamore, kanë zhvillim dhe dimensione të kënaqshme për përdorim dhe nuk kanë defekte që dëmtojnë cilësinë ose që ulin vlerën e përdorimit;

ç) në lidhje me identitetin varietor, nga ana pamore, varieteti dallohet nga veçoritë botanike, morfologjike, biologjike e agroteknologjike dhe plotëson qëllimin e përdorimit;

d) në lidhje me pastërtinë varietore, plotësohen kërkesat e përcaktuara në pikën 2, të kreut III, të këtij vendimi, për mbajtjen të papërziera të varieteteve dhe specieve të materialeve të shumëzimit e fidanëve të bimëve zbukuruese;

dh) në rastin e farërave, nga ana pamore kanë pamje dhe zhvillim të kënaqshëm.



3. Materialet e shumëzimit dhe fidanët që tregojnë shenja ose simptoma të dukshme të organizmave dhe sëmundjeve të dëmshëm, të listuar në aneksin 2 të këtij vendimi, trajtohen menjëherë dhe, nëse kërkesat për pastërtinë nga organizmat dhe sëmundjet e dëmshëm përsëri nuk mund të plotësohen, materialet e shumëzimit ose dhe fidanët hiqen dhe shkatërrohen.

4. Përveç kërkesave të përcaktuara në pikën 2 të këtij kreu, materialet shumëzuese dhe fidanët e specieve të gjinisë *Citrus L.* duhet të plotësojnë edhe kërkesat e mëposhtme:

a) Të kenë prejardhje nga material fillestar, që është kontrolluar dhe është konstatuar se nuk tregon simptoma të ndonjë virusi ose organizmi të ngjashëm me viruset;

b) Të jenë kontrolluar dhe gjetur se janë të pastër nga viruset ose nga organizmat e ngjashëm me viruset që nga fillimi deri në fund të ciklit të fundit të vegetacionit;

c) Në rastin e shartimit, materiali shumëzues të jetë shartuar mbi nënshartesë rezistente ndaj virozave;

ç) Të jenë certifikuar në përputhje me kërkesat dhe sipas procedurave të përcaktuara për materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve drufrutore, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Përveç kërkesave të përcaktuara në pikën 2 të këtij kreu, në rastin e bulbeve dhe zhardhokëve të luleve, materialet e shumëzimit dhe fidanët duhet të kenë prejardhje të drejtpërdrejtë nga një material, i cili, gjatë fazës së rritjes, është kontrolluar dhe ka rezultuar i pastër nga organizmat dhe sëmundjet karantinore, si dhe nga organizmat dhe sëmundjet e dëmshëm, të listuar në aneksin 2 të këtij vendimi.

6. Me përjashtim të kërkesës të përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 2, të këtij kreu, kërkesat e mësipërme nuk zbatohen për materialet e shumëzimit dhe fidanët e destinuar për prova krahasimi e për qëllime shkencore.

III. KËRKESAT PËR FURNIZUESIT

1. Furnizuesit që prodhojnë, përgatisin për treg, importojnë dhe/ose tregojnë materiale shumëzimi dhe fidanë të bimëve zbukuruese, duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

a) Të jenë të regjistruar dhe të licencuar në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi;

b) Të regjistrohen në regjistrin e furnizuesve, që mbahet nga autoriteti certifikues;

c) Të regjistrohen në regjistrin e mbajtësve të bimëve të caktuara, produkteve bimore dhe objekteve të rregulluara për qëllimet e shëndetit të bimëve, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e shëndetit të bimëve;

ç) Kur është e nevojshme, të autorizohen nga struktura përkatëse e mbrojtjes së bimëve për lëshimin e pasaportës bimore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e bimëve.

2. Furnizuesit sigurojnë përputhshmërinë e materialeve të shumëzimit dhe/ose të fidanëve me kërkesat e këtij vendimi, duke përmbushur detyrimet e mëposhtme:

a) Të kenë planin e prodhimit, i cili të përmbajë informacion për shqyrtim, kur kërkohet nga organi përgjegjës zyrtar për monitorimin, si më poshtë vijon:

i) Një kopje të planimetrisë kadastrale të vendndodhjes së veprimtarisë së furnizuesit, ku tregohen me saktësi objektet dhe fushat e tokës bujqësore që përdoren për prodhimin e materialeve të shumëzimit dhe/ose të fidanëve, duke përfshirë edhe zonën mbrojtëse përkatëse;

ii) Planin e mbjelljes;

iii) Planin teknologjik;

iv) Planin për kryerjen e identifikimit dhe mbikëqyrjes së organizmave të dëmshëm në bimët, që ndikojnë në cilësinë e materialit, në objektet dhe në tokën ku materialet e shumëzimit dhe/ose fidanët prodhohen ose përgatiten për treg;

b) Në mënyrë të përshtatshme, sipas planit të prodhimit, të përcaktuar në shkronjën “a” të kësaj pike, të kryejnë:

i) procedurat e planifikuara teknologjike dhe të mbajnë të dhënat për zbatimin e tyre, sipas datave dhe llojit të procedurës ose detyrat e kryera dhe metodën e zbatimit;

ii) mbikëqyrjen e rregullt për organizmat dhe sëmundjet e dëmshëm, të listuara në aneksin 2, të këtij vendimi;

iii) marrjen e mostrave dhe t'i dërgojnë ato në laboratorin e akredituar për analizat, si dhe të marrin masat e nevojshme për zvogëlimin e rrezikut të shfaqjes ose përhapjes së tyre;

c) Mbajtjen e regjistrit të të dhënave për mbikëqyrjen e organizmave dhe të sëmundjeve të dëmshëm, në lidhje me:

i) datën e shfaqjes së mundshme për çdo organizëm dhe sëmundje të dëmshëm, të listuar në aneksin 2 të këtij vendimi dhe të gjitha masat që



merren për parandalimin e përhapjen e tij, veçanërisht në lidhje me trajtimet ose heqjen dhe shkatërrimin e materialeve të shumëzimit dhe/ose të fidanëve;

ii) datën dhe metodën e marrjes së mostrave të bimëve ose të tokës;

c) Të njoftojnë, menjëherë, inspektorin përgjegjës fitosanitar, në rast të shfaqjes ose dyshimit të shfaqjes së organizmave karantinorë;

d) Të mundësojnë kryerjen e mbikëqyrjes ose inspektimit zyrtar, marrjen e mostrave zyrtare, kur është e nevojshme për analiza në një laborator me pajisje dhe ekspertizë të përshtatshme dhe, menjëherë pas inspektimit, të marrin masat për zbatimin e detyrave të lëna nga inspektori përgjegjës fitosanitar;

dh) Të sigurojnë që lotet ose porcionet e veçanta të materialeve të shumëzimit dhe/ose të fidanëve, gjatë prodhimit, magazinimit, përgatitjes për treg dhe tregtimit, janë të ndara;

e) Të mbajnë shënime për origjinën e materialeve të shumëzimit të përdorura për prodhimin e fidanëve të bimëve zbukuruese. Furnizuesit duhet të mbajnë shënime për speciet, varietetin, numrin referues të lotit ose porcionit, sasinë, datën e marrjes ose blerjes dhe të dhënat e prejardhjes së materialeve të shumëzimit dhe/ose të fidanëve në lidhje me furnizuesin dhe vendin e prodhimit;

ë) Të mbajnë shënime për prodhimin, blerjen, specien, varietetin, sasinë, numrin referues të lotit ose porcionit, sasinë dhe datën e prodhimit ose të blerjes së materialeve të shumëzimit dhe/ose të fidanëve;

f) Të mbajnë të dhëna për përbërjen e ngarkesave me materiale shumëzimi dhe/ose fidanë që shesin ose shpërndajnë, për datën e shitjes e të shpërndarjes, si dhe numrin referues të lotit ose porcionit, sipas specieve dhe varieteteve;

g) Në rastet kur, para tregtimit, lotet ose porcionet e materialeve të shumëzimit dhe/ose të fidanëve me prejardhje të ndryshme vihen të përziera së bashku, furnizuesi të mbajë regjistrin e përbërjes së një ngarkese, me të dhëna për sasinë, numrin e njërive të loteve ose të porcioneve të veçanta, që përbëjnë lotin ose porcionin e përzier;

gj) Të mbajnë të dhënat për dokumentet dhe etiketat e furnizuesit, të nxjerra në përputhje me kërkesat e përcaktuara për materialet e shumëzimit dhe/ose fidanët që tregtohen në

porcione, sipas përcaktimit të këtij vendimi për paketimin dhe etiketimin.

3. Furnizuesit ruajnë të dhënat e përcaktuara në shkronjat “b”, “c”, “e”, “ë”, “f”, “g” dhe “gj”, të pikës 2 të këtij kreu, si dhe provat në bazë të të cilave ata i kanë regjistruar të dhënat për të paktën tre vjet pas kalimit të vitit kalendarik, kur të dhënat janë regjistruar.

4. Furnizuesit, veprimtaria e të cilëve përqendrohet vetëm në tregtimin e materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve në blerjen me shumicë, brenda dhe jashtë vendit, si dhe shitjen me shumicë e pakicë, mbajnë të regjistruara, për të paktën 12 muaj, shënimet përkatëse për datën dhe sasinë e blerjeve, shitjeve, shpërndarjeve të tyre sipas specieve, varieteteve e numrit të referencës për lotin ose porcionin.

IV. KËRKESAT PËR CERTIFIKIMIN E MATERIALEVE TË SHUMËZIMIT DHE FIDANËVE TË BIMËVE ZBUKURUESE

IV.1 Kërkesa për certifikim

1. Certifikimi i materialeve të shumëzimit dhe/ose të fidanëve të bimëve zbukuruese kryhet mbi bazën e prodhimit të deklaruar nga furnizuesi në kërkesën e paraqitur tek autoriteti certifikues, sipas rregullave të mëposhtme:

a) Kërkesa paraqitet çdo vit, jo më vonë se data 30 prill ose, në rastin e bimëve me disa cikle vegetacioni në një vit, jo më vonë se një muaj para fillimit të prodhimit dhe përmban të dhëna për:

i) furnizuesin;

ii) aktivitetin që kryhet;

iii) personin përgjegjës të kualifikuar;

iv) materialet e shumëzimit dhe/ose fidanët e bimëve zbukuruese.

b) Forma, përmbajtja e kërkesës dhe dokumentacioni që i bashkëngjitet kërkesës është sipas modelit 1, të aneksit 4, bashkëngjitur këtij vendimi;

c) Autoriteti certifikues shqyrton kërkesën për certifikim brenda 20 ditëve pune nga paraqitja e saj dhe njofton zyrtarisht furnizuesit për pranimin ose jo të kërkesës, brenda 10 ditëve pune pas përfundimit të shqyrtimit;

ç) Kërkesa e furnizuesit për certifikim pranohet, nëse:

i) është paraqitur dhe plotësuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në shkronjën “a” dhe “b”, të pikës 1, të këtij kreu;



ii) materialet e shumëzimit dhe fidanët prodhohen, etiketohen dhe vendosen në treg nga persona përgjegjës të kualifikuar;

iii) materialet e shumëzimit dhe/ose fidanët që kërkohen për certifikim u përkasin varieteteve ose në rastin e nënshartesave, u përkasin specieve dhe hibrideve ndërmjet tyre e që janë regjistruar në katalogun kombëtar;

iv) modeli i etiketës së propozuar nga furnizuesi është në përputhje me kërkesat e këtij vendimi dhe modeli i certifikatës së origjinës është sipas modelit 5, të aneksit 4, të këtij vendimi.

2. Në rastet kur, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e bimëve, materialet e shumëzimit dhe/ose fidanët e bimëve zbukuruese duhet të shoqërohen me pasaportë bimore, së bashku me kërkesën e përcaktuar në pikën 1 të këtij kreu, furnizuesi paraqet kërkesë pranë strukturave të shërbimit të mbrojtjes së bimëve për pajisjen me pasaportë bimore.

IV.2 Procedurat e lëshimit të certifikatës zyrtare për materialet e shumëzimit dhe/ose për fidanët e bimëve zbukuruese

1. Furnizuesi që prodhon materiale shumëzimi dhe/ose fidanë të bimëve zbukuruese për tregtim lejohet t'i tregtojë ato pasi të jenë certifikuar nga autoriteti certifikues dhe të jetë autorizuar për nxjerrjen dhe lëshimin e etiketave e të dokumenteve të tjera të furnizuesit.

2. Autoriteti certifikues lëshon certifikatën kur, nga mbikëqyrja e ushtruar, rezulton se plotësohen kërkesat e përcaktuara në këtë vendim.

3. Autoriteti certifikues, të paktën një herë gjatë ciklit të vegjetacionit, kryen mbikëqyrje për të verifikuar nëse furnizuesi plotëson detyrimet e përcaktuara në kreun III të këtij vendimi e, veçanërisht, nëse:

a) materialet e shumëzimit dhe/ose fidanët që prodhon janë në përputhje me planin e prodhimit, të përcaktuar në pikën 2, të kreut III, të këtij vendimi;

b) kryen me korrektësi vërtetimet për organizmat dhe sëmundjet e dëmshëm të bimëve, në vendin dhe objektet ku materialet e shumëzimit dhe/ose fidanët prodhohen e përgatiten për treg;

c) mban të dhënat e përcaktuara dhe ruan evidencën, në përputhje me pikën 4, të kreut III, të këtij vendimi;

ç) mostrat për analiza janë marrë në përputhje me planin e prodhimit, si më poshtë vijon:

i) në kohën e duhur;

ii) në mënyrën e duhur teknike;

iii) duke përdorur metodë statistikore të besueshme;

d) analiza e mostrës është kryer nga laboratorit i akredituar.

4. Gjatë mbikëqyrjes që autoriteti certifikues kryen te furnizuesi, në përputhje me përcaktimet e pikës më lart, kontrollon planin e prodhimit, veçanërisht për sa u përket përshtatshmërisë dhe besueshmërisë së metodave të përdorura për monitorimin dhe mbikëqyrjen e organizmave e të sëmundjeve të dëmshëm, të specifikuar në aneksin 2 të këtij vendimi, duke përfshirë planin për marrjen e mostrave në faza të ndryshme të prodhimit ose në intervale të përshtatshme kohore.

5. Në bazë të të dhënave nga mbikëqyrjet e kryera dhe nga aktverifikimet e mbajtura në vend, sipas modeleve 2/1 dhe 3/1, të aneksit 4, autoriteti certifikues i lëshon furnizuesit certifikatën zyrtare sipas modeleve 2 e 3, të aneksit 4, të këtij vendimi.

6. Nëse vërtetohet se materialet e shumëzimit, që përdoren për prodhimin e fidanëve, plotësojnë kërkesat dhe gjatë rritjes, jo më pak se dy muaj para shkuljes ose lëvizjes së fidanëve për tregtim, autoriteti certifikues autorizon furnizuesin për nxjerrjen e etiketës dhe të certifikatës së origjinës. Përmbajtja dhe forma e autorizimit është sipas modelit 4, të aneksit 4, të këtij vendimi.

7. Gjatë paketimit dhe vendosjes së etiketave furnizuesi mbikëqyret nga autoriteti certifikues, i cili vërteton sasinë përfundimtare të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të prodhuar në fidanishte, plotësimin e kërkesave të cilësisë, paketimin dhe etiketimin, si dhe numrin e etiketave të lëshuara nga furnizuesi.

8. Për speciet e gjinive *Malus Mill.*, *Prunus L.*, *Pyrus L.* dhe *Citrus*, që përfshihen në listën e aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi, certifikimi kryhet sipas kriterëve të përcaktuara për materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve drufrutore sipas legjislacionit në fuqi, ndërsa për speciet e gjinive që u përkasin bimëve pyjore, si *Pinus nigra* etj., certifikimi kryhet sipas kriterëve të përcaktuara për materialet riprodhuese pyjore, sipas legjislacionit në fuqi.



V. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve zbukuruese, të cilët deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi janë prodhuar në përputhje me legjislacionin e mëparshëm, mund të tregtohen deri më 30 shtator 2016.

2. Materialet e shumëzimit dhe fidanët e pashitur, pas datës 30 shtator 2016, ricertifikohen, për të plotësuar kërkesat për tregtim dhe certifikim sipas këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

ANEKSI 1

LISTA E GJINIVE DHE SPECIEVE TË PËRMENDURA NË PIKËN 2, TË NËNKREUT I.1, TË KREUT I, TË KËTIJ VENDIMI²

- Begonia x hiemalis Fotsch- Begonia
- Elatior-Begonia
- Pelargonium L.- Barbarosa
- Pelargonium (zonale, ivy-leaved, regal)
- Dendranthema x grandiflorum- Margarita
- (Ramat.) Kitam.
- Chrysanthemum (florists chrysanthemum)
- Dianthus caryophyllus L. and hybrids- Karafili
- Carnation
- Euphorbia pulcherrima Wild ex Kletsch- Lulja e Krishtlindjeve
- Gerbera L.- Gerbera
- Gerbera
- Phoenix- Palma
- Rosa- Trëndafili
- Citrus (ornamental)- Agrumet zbukuruese
- Malus Miller (ornamental)- Molla zbukuruese
- Ornamental Apple
- Pinus nigra (ornamental)- Pisha e zezë zbukuruese
- Prunus L. (ornamental)
- Ornamental Cherry- Qershia zbukuruese
- Pyrus L. (ornamental)
- Ornamental Pear- Dardha zbukuruese
- Lilium L.
- Lily- Zambaku
- Gladiolus L.
- Gladiolus- Zambak shpatë, lule gladiola
- Narcissus L.
- Daffodil.- Narcis i verdhë,

² Sipas "ANNEX 1", të direktivës së Këshillit 91/682/EEC, e datës 19 dhjetor 1991, për tregtimin e materialeve shumëzuese të bimëve zbukuruese dhe të bimëve zbukuruese.



ANEKSI 2
LISTA E ORGANIZMAVE DHE SËMUNDJEVE SPECIFIKË, TË DËMSHËM QË PREKIN
CILËSINË³

Gjinia ose specia	Organizmat dhe sëmundjet e dëmshëm specifikë
Begonia x hiemalis Fotsch - BEGONIA	Insektet, akaret dhe nematodat në gjithë fazat e zhvillimit të tyre: — Aleurodidae, veçanërisht” <i>Bemisia tabaci</i> — Aphelenchoides spp. — Ditylenchus destructor — Meloidogyne spp. — Myzus ornatus — Otiorrhynchus sulcatus — Sciara — Thysanoptera, veçanërisht <i>Frankliniella occidentalis</i> Bakteret: — Erwinia chrysanthemi — Rhodococcus fascians — Xanthomonas campestris pv. begoniae Sëmundjet kërpudhore: — Powdery mildew — Stem rot pathogens (Phytophthora spp., Pythium spp. and Rhizoctonia spp.) Viruset dhe organizmat e ngjashëm me viruset dhe, veçanërisht: — Leafcurl disease — Tospoviruses (Tomato spotted wilt virus, Impatiens necrotic spot virus)
Citrus AGRUMET	Insektet, akaret dhe nematodat në gjithë fazat e zhvillimit të tyre: — Aleurothrixus floccosus (Mashell) — Meloidogyne spp. — Parabemisia myricae (Kuwana) — Tylenchulus semipenetrans Sëmundjet kërpudhore; — Phytophthora spp. Viruset dhe organizmat e ngjashëm me viruset dhe, veçanërisht: — Viroids such as exocortis, cachexia-xyloporosis — Diseases that induce psorosis - like young leaves — symptoms such as: — psorosis, ring spot, cristicortis, impietratura, concave gum — Infectious variegation — Citrus leaf rugose
Dendranthema Grandiflorum (Ramet) Kitam -MARGERITA (KRIZANTEMA)	x Insektet, akaret dhe nematodat në gjithë fazat e zhvillimit të tyre: — Agromyzidae — Aleurodidae, veçanërisht <i>Bemisia tabaci</i> — Aphelencoides spp. — Diarthronomia chrysanthemi — Lepidoptera, veçanërisht <i>Cacoecimorpha pronubana</i>, <i>Epichoristodes Acerbella</i> — Thysanoptera, veçanërisht <i>Frankliniella occidentalis</i>

³ Sipas aneksit të direktivës së komisionit 93/49 të 23 qershor 1993, që përcakton listën që tregon kushtet që duhet të plotësohen nga materiali shumëzues i bimëve zbukuruese dhe nga bimët zbukuruese në përputhje me direktivën e Këshillit 91/682/EEC.



	Bakteret: — <i>Agrobacterium tumefaciens</i> — <i>Erwinia chrysanthemi</i> Sëmundjet kërpudhore: — <i>Fusarium oxysporum</i> spp. <i>chrysanthemi</i> — <i>Puccinia chrysanthemi</i> — <i>Pythium</i> spp. — <i>Rhizoctonia solani</i> — <i>Verticillium</i> spp. Viruset dhe organizmat e ngjashëm me viruset dhe, veçanërisht: — <i>Chrysanthemum B</i> mosaic virus — Tomato aspermy cucumovirus
Dianthus Caryophyllus L. and hybrids KARAFILAT	Insektet, akaret dhe nematodat në gjithë fazat e zhvillimit të tyre: — Agromyzidae — Aleurodidae, veçanërisht: <i>Bemisia tabaci</i> — Thysanoptera, veçanërisht: <i>Frankliniella occidentalis</i> — Lepidoptera, veçanërisht: <i>Cacoecimorpha pronubana</i>, <i>Epichoristodes acerbella</i> Sëmundjet kërpudhore: — <i>Alternaria dianthi</i> — <i>Alternaria dianthicola</i> — <i>Fusarium oxysporum</i> f. spp. <i>dianthi</i> — <i>Mycosphaerella dianthi</i> — <i>Phytophthora nicotiana</i> spp. <i>parasitica</i> — <i>Rhizoctonia solani</i> — Stem rot: <i>Fusarium</i> spp. and <i>Pythium</i> spp. — <i>Uromyces dianthi</i> Viruset dhe organizmat e ngjashëm me viruset dhe, veçanërisht: — Carnation etched ring caulimovirus — Carnation mottle carmovirus — Carnation necrotic fleck closterovirus — Tospoviruses (Tomato spotted wilt virus, Impatiens necrotic spot virus)
Euphorbia pulcherrima (Wild ex Kletzch) LULJA KRISHTLINDJEVE	Insektet, akaret dhe nematodat në gjithë fazat e zhvillimit të tyre: — Aleurodidae, veçanërisht: <i>Bemisia tabaci</i> Bakteret: — <i>Erwinia chrysanthemi</i> Sëmundjet kërpudhore: — <i>Fusarium</i> spp. — <i>Pythium ultimum</i> — <i>Phytophthora</i> spp. — <i>Rhizoctonia solani</i> — <i>Thielaviopsis basicola</i> Viruset dhe organizmat e ngjashëm me viruset, dhe veçanërisht: - Tospoviruses (Tomato spotted wilt virus, Impatiens necrotic spot virus)
— Gerbera L. GERBERA	Insektet, akaret dhe nematodat në gjithë fazat e zhvillimit të tyre: — Agromyzidae — Aleurodidae, veçanërisht: <i>Bemisia tabaci</i> — Aphelenchoides spp. — Lepidoptera — Meloidogyne — Thysanoptera, veçanërisht:



	<i>Frankliniella occidentalis</i> Sëmundjet kërpudhore: — Fusarium spp. — Phytophthora cryptogea — Powdery mildew — Rhizoctonia solani — Verticillium spp. Viruset dhe organizmat e ngjashëm me viruset, dhe veçanërisht: Tospoviruses (Tomato spotted wilt virus, Impatiens necrotic spot virus)
— Gladiolus L. GLADIOLAT (LULE SHPATA)	Insektet, akaret dhe nematodat në gjithë fazat e zhvillimit të tyre — Ditylenchus dipsaci — Thysanoptera, veçanërisht: <i>Frankliniella occidentalis</i> Bakteret: — Pseudomonas marginata — Rhodococcus fascians Sëmundjet kërpudhore: — Botrytis gladiolorum — Curvularia trifolii — Fusarium oxysporum spp. gladioli — Penicillium gladioli — Sclerotinia spp. — Septoria gladioli — Urocystis gladiolicola — Uromyces transversalis Viruset dhe organizmat e ngjashëm me viruset dhe veçanërisht: — Aster yellow mycoplasma — Corky pit agent — Cucumber mosaic virus — Gladiolus ringspot virus (syn. Narcissus latent virus) — Tobacco rattle virus Të tjerë organizma të dëmshëm: — Cyperus esculentus
— Lilium L. ZAMBAKORE	Insektet, akaret dhe nematodat në gjithë fazat e zhvillimit të tyre: — Aphelenchoides spp. — Rhyzoglyphus spp. — Pratylenchus penetrans — Rotylenchus robustus — Thysanoptera, veçanërisht: <i>Frankliniella occidentalis</i> Bakteret: — Erwinia carotovora subsp. carotovora — Rhodococcus fascians Sëmundjet kërpudhore: — Cylindrocarpon destructans — Fusarium oxysporum f. sp. lilii — Pythium spp. — Rhizoctonia spp. — Rhizopus spp. — Sclerotium spp. Viruset dhe organizmat e ngjashëm me viruset dhe, veçanërisht: — Cucumber mosaic virus — Lily symptomless virus — Lily virus x — Tobacco rattle virus



	— Tulip breaking virus Të tjerë organizma të dëmshëm: — <i>Cyperus esculentus</i>
— Malus Miller MOLLA ZBUKURUESE	Insektet, akaret dhe nematodat në gjithë fazat e zhvillimit të tyre: — <i>Anarsia lineatella</i> — <i>Eriosoma lanigerum</i> — Scale insects, veçanërisht: <i>Epidiaspis leperii</i>, <i>Pseudaulacaspis pentagona</i>, <i>Quadraspidiotus perniciosus</i> Bakteret: — <i>Agrobacterium tumefaciens</i> — <i>Pseudomonas syringae</i> pv. <i>syringae</i> Sëmundjet kërpudhore: — <i>Armillariella mellea</i> — <i>Chondrostereum purpureum</i> — <i>Nectria galligena</i> — <i>Phytophthora cactorum</i> — <i>Rosellinia necatrix</i> — <i>Venturia</i> spp. — <i>Verticillium</i> spp. Viruset dhe organizmat e ngjashëm me viruset: <i>Të gjitha</i>
— Narcissus L. NARCIS I VERDHË	Insektet, akaret dhe nematodat në gjithë fazat e zhvillimit të tyre: — <i>Aphelenchoides subtenuis</i> — <i>Ditylenchus destructor</i> — <i>Eumerus</i> spp. — <i>Merodon equestris</i> — <i>Pratylenchus penetrans</i> — Rhizoglyphidae — Tarsonemidae Sëmundjet kërpudhore: — <i>Fusarium oxysporum</i> f. sp. <i>narcissi</i> — <i>Sclerotinia</i> spp. — <i>Sclerotium bulborum</i> Viruset dhe organizmat e ngjashëm me viruset dhe, veçanërisht: — Tobacco rattle virus — Narcissus white streak agent — Narcissus yellow stripe virus Të tjerë organizma të dëmshëm — <i>Cyperus esculentus</i>
— Pelargonium L. BARBAROZA	Insektet, akaret dhe nematodat në gjithë fazat e zhvillimit të tyre: — Aleurodidae, veçanërisht: <i>Bemisia tabaci</i> — Lepidoptera — Thysanoptera, veçanërisht: <i>Frankliniella occidentalis</i> Bakteret: — <i>Rhodococcus fascians</i> — <i>Xanthomonas campestris</i> pv. <i>pelargonii</i> Sëmundjet kërpudhore: — <i>Puccinia pelargonii</i> zonalis — Stem rot pathogens (<i>Botrytis</i> spp., <i>Pythium</i> spp.) — <i>Verticillium</i> spp. Viruset dhe organizmat e ngjashëm me viruset dhe, veçanërisht:



	— Pelargonium flower break carmovirus — Pelargonium leaf curl tombusvirus — Pelargonium line pattern virus — Tospoviruses (Tomato spotted wilt virus, Impatiens necrotic spot virus)
— Phoenix PALMA	Insektet, akaret dhe nematodat në gjithë fazat e zhvillimit të tyre: — Thysanoptera Sëmundjet kërpudhore: — Exosporium palmivorum — Gliocladium wermoeseni — Graphiola phoenicis — Pestalozzia Phoenicis — Pythium spp. Viruset dhe organizmat e ngjashëm me viruset : <i>Të gjitha</i>
— Pinus nigra PISHA E ZEZË ZBUKURUESE	Insektet, akaret dhe nematodat në gjithë fazat e zhvillimit të tyre: — Blastophaga spp. — Rhyacionia buoliana Sëmundjet kërpudhore — Ophodermium seditiosum Viruset dhe organizmat e ngjashëm me viruset dhe, veçanërisht: <i>Të gjitha</i>
Prunus L. (bërthamorët) QERSHIA ZBUKURUESE	Insektet, akaret dhe nematodat në gjithë fazat e zhvillimit të tyre: — Capnodis tenebrionis — Meloidogyne spp. — Scale insects, veçanërisht: <i>Epidiaspis leperii, Pseudaulacaspis pentagona, Quadraspidiotus perniciosus</i> Bakteret: — Agrobacterium tumefaciens — Pseudomonas syringae pv. mors prunorum — Pseudomonas syringae pv. syringae Sëmundjet kërpudhore: — Armillariella mellea — Chondrostereum purpureum — Nectria galligena — Rosellinia necatrix — Taphrina deformans — Verticillium spp. Viruset dhe organizmat e ngjashëm me viruset dhe, veçanërisht: <i>Prune dwarf virus</i> <i>Prunus necrotic ringspot virus</i>
— Pyrus L. DARDHA ZBUKURUESE	Insektet, akaret dhe nematodat në gjithë fazat e zhvillimit të tyre: — Anarsia lineatella — Eriosoma lanigerum — Scale insects, veçanërisht <i>Epidiaspis leperii, Pseudaulacaspis pentagona, Quadraspidiotus perniciosus</i> Bakteret: — Agrobacterium tumefaciens — Pseudomonas syringae pv. syringae Sëmundjet kërpudhore: — Armillariella mellea — Chondrostereum purpureum — Nectria galligena



— Rosa TRËNDAFILI	— Phytophthora spp. — Rosellinia necatrix — Verticillium spp.
	Viruset dhe organizmat e ngjashëm me viruset: Të gjitha
	Insektet, akaret dhe nematodat në gjithë fazat e zhvillimit të tyre: — Lepidoptera, veçanërisht: <i>Epichoristodes acerbella</i> , <i>Cacoecimorpha pronubana</i> — Meloidogyne spp. — Pratylenchus spp. — Tetranychus urticae
	Bakteret: — Agrobacterium tumefaciens
	Sëmundjet kërpudhore: — Chondrostereum purpureum — Coniothyrium spp. — Diplocarpon rosae — Peronospora sparsa — Phragmidium spp. — Rosellinia necatrix — Sphaeroteca pannosa — Verticillium spp.
	Viruset dhe organizmat e ngjashëm me viruset dhe, veçanërisht: — <i>Apple mosaic virus</i> — <i>Arabid mosaic nepovirus</i> — <i>Prunus necrotic ringspot virus</i>

ANEKSI 3 KËRKESAT PËR PAKETIMIN DHE ETIKETIMIN

1. Materiali shumëzues tregtohet në lote ose porcione të paketuara dhe të etiketuara nga furnizuesi në paketa për një ose më shumë copë së bashku, me kusht që:

a) të sigurohet origjinaliteti i paketimit dhe etiketimit;

b) paketimi të jetë i tillë që nuk mund të hapet pa lënë shenja të dukshme në etiketë ose në paketim;

c) materiali i përdorur për paketim të jetë i tillë që të mbrojë materialin shumëzues ose fidanët nga dehidratimi, temperaturat e ulëta dhe dëmtime të tjera që mund të ndodhin gjatë transportit ose tregtimit. Për çdo njësi të pakeluar individualisht vendoset një etiketë e furnizuesit.

2. Në rastin kur para tregtimit vendosen së bashku ose të përziera lote, porcione ose tufa, furnizuesi mban një regjistër me të dhëna të dokumentuara në përputhje me përcaktimin e bërë në shkronjën “g”, të pikës 2, të kreut III, të këtij vendimi.

3. Etiketa e furnizuesit, e prodhuar për materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve zbukuruese, duhet të jetë nga material i qëndrueshëm ndaj agentëve atmosferikë dhe i papërdorur.

4. Etiketa e furnizuesit përmban informacionin e detyrueshëm, si më poshtë vijon:

- shteti: (emri i shtetit, Republika e Shqipërisë, “RSH”);

- organi zyrtar, përgjegjës për certifikimin ose kodi i tij dallues;

- furnizuesi: (emri i furnizuesit dhe adresa);

- kodi i regjistrimit të furnizuesit: (numri);

- loti /lotet ose ngarkesa: (numri ose numrat referues të tyre ose serisë);

- data e lëshimit të etiketës së furnizuesit;

- lloji: (emërtimi i materialit shumëzues ose i fidanit të bimëve zbukuruese, i shartuar ose i pashartuar);

- specia: (emri botanik);

- varieteti/hibridi: (emri i varietetit/hibridit);

- nënshartesa: (sipas rastit: emri i varietetit/hibridit ose kodi i tij bazë);

- sasia;



- vendi i prodhimit: (emri i shtetit në rastin e importeve nga vendet e tjera).

5. Nëse materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve zbukuruese shoqërohen me një pasaportë bimore, në përputhje me rregullat e përcaktuara në legjislacionin për mbrojtjen e bimëve, pasaporta bimore do të konsiderohet si etiketë ose dokument i furnizuesit, me kusht që furnizuesi duhet të japë informacionin e mëposhtëm shtesë, i cili mund të jetë dokument i njëjtë me pasaportën bimore, por i ndarë në mënyrë të qartë nga të dhënat e tjera:

- organi zyrtar, përgjegjës që autorizon lëshimin e pasaportës bimore:

- varieteti/hibridi:

- nënshartesa: (sipas rastit: emri i varietetit, hibridit ose kodi i saj bazë)

- vendi i prodhimit:

6. Në rastin e materialeve të shumëzimit dhe/ose të fidanëve të specieve të përfshira në listën e specieve dhe hibrideve artificiale, të përcaktuara në rregullat për materialin riprodhues pyjor, sipas rastit, etiketa dhe pasaporta bimore, të përcaktuara në pikat 4 e 5 të këtij aneksi, duhet të përmbajnë treguesin e detyrueshëm “JO PËR NË PYLLTARË”.

7. Nëse materiali shumëzues është farë e trajtuar me një produkt për mbrojtjen e bimëve (që më pas do të shkruhet “PMB”), etiketa ose dokumenti i furnizuesit ose pasaporta bimore, të përcaktuara më sipër, duhet të përfshijnë treguesin “trajtuar me: dhe emri i PMB-së”.

8. Në rastin kur materialet e shumëzimit dhe/ose fidanët e bimëve zbukuruese destinohen për përdorim përfundimtar nga persona në tregun vendor, të cilët nuk janë të përfshirë profesionalisht në prodhimin dhe shitjen e materialeve të shumëzimit dhe/ose të fidanëve, nuk është e nevojshme që furnizuesit t’u përmbahen kërkesave të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij aneksi. Në këtë rast, furnizuesit pajisin materialet e shumëzimit dhe/ose fidanët me informacionin bazë, si më poshtë vijon:

- emri botanik:

- emri i varietetit:

- emri/emërtimi i nënshartesës:

9. Rregullat e përcaktuara në pikën 8 nuk zbatohen në rastin e materialeve të shumëzimit dhe/ose fidanëve që, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e bimëve, duhet të shoqërohen nga një pasaportë bimore në të gjitha fazat e lëvizjes ose të tregtimit me qëllim të kultivimit të mëtejshëm ose deri duke përfshirë dhe tregtinë me pakicë.

10. Për të treguar emrin e varietetit të përdorur për materialet e shumëzimit dhe/ose fidanët ose, në rastin e nënshartesave, emrin ose emërtimin e nënshartesës, furnizuesit duhet të kenë parasysh nëse varieteti plotëson kërkesat, si më poshtë vijon:

a) është i njohur dhe i mbrojtur, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e varieteteve të reja dhe të të drejtave të seleksionerit të bimëve;

b) është i regjistruar në katalogun kombëtar të varieteteve.

ANEKSI 4

DOKUMENTET PËR CERTIFIKIM

Model 1

KËRKESË PËR CERTIFIKIM

Të: -- bllokut të bimëve mëmë ☐

– parcelës së farës ☐

– fidanishtes së materialeve të shumëzimit dhe fidanëve të bimëve zbukuruese ☐

Drejtuar: Organit certifikues _____

I nënshkruari _____, në cilësinë e furnizuesit për prodhimin, _____

prodhimin dhe tregtimin, _____

përgatitjen për treg dhe tregtimin _____

e materialeve të shumëzimit dhe/ose fidanëve të bimëve zbukuruese, kërkoj aprovimin e bllokut të bimëve mëmë ose dhe të fidanishtes, për prerjen, marrjen, shkuljen dhe lëvizjen e materialeve të shumëzimit dhe fidanëve të bimëve zbukuruese si vijon:



a) Të dhëna për furnizuesin:

1. Emri e mbiemri: _____, emërtimi i subjektit (firmës) _____
2. Adresa: e vendbanimit _____, e zyrës _____
3. Vendndodhja e aktivitetit: _____
4. Kodi i furnizuesit: _____, 5. Numri i licencës: _____

b) Të dhëna për personin përgjegjës të kualifikuar:

1. Emri e mbiemri: _____
2. Adresa: e vendbanimit _____, e zyrës _____
3. Arsimi: _____
4. Specializimi: _____

c) Të dhëna për bllokun e bimëve mëmë ☐ ose dhe parcelës së farës ☐ për certifikim dhe parashikimi i prodhimit të materialeve të shumëzimit:

Nr.	Speciet, varietetet dhe/ose, për nënshartesat, hibridet ndërmjet specieve.	Sipërfaqja m ²	Numri i bimëve gjithsej	Parashikim prodhimi për vitin në vijim							
				Sytha për shartim	Kalema për shartim	Kalema për rrënjëzim	Fun-dakë Copë	Kamza për rrënjëzim copë	Lastunja copë	Fara kg	Copa të rrënjëzuara ose për rrënjëzim copë
	Gjithsej										
1.	Specia.....										
	Varieteti.....										

d) Të dhëna për fidanishten

Nr.	Speciet, varietetet dhe/ose, për nënshartesat, filizat sipas specieve dhe hibridet ndërmjet specieve.	Sipërfaqja gjithsej m ²	Nga kjo:		Parashikimi i prodhimit për tregtim, për vitin në vijim, rrënjë				
			Për nënshartesa (farishte, vijë fidanishte, copa për rrënjëzim etj.) m ²	Për fidanë (nga shartesat etj. deri te fidanët për shkulje)	Fidanë	Materiale shumëzimi			
	Gjithsej								
1.	Specia.....								
	Varieteti.....								

Bashkëngjitur kërkesës së përmendur më sipër është plani i prodhimit, me përmbajtje si vijon:

i) në rastin e bllokut mëmë të bimëve shumëvjeçare: planvendosja e bllokut mëmë me të gjitha të dhënat e detajuara në skemën e mbjelljes për speciet, varietetet dhe në rastin e nënshartesave, për hibridet ndërmjet specieve, si dhe origjina e tyre;

ii) në rastin e prodhimit të fidanëve: një dokument në lidhje me çdo fushë të fidanishtes, i cili të përmbajë:

- kopje të hartës së regjistratit të tokës ku tregohet blloku i bimëve mëmë, parcela/t e farës dhe/ose fidanishtja me të gjitha fushat dhe mjediset e saj;

- skemën e ngritjes së bllokut mëmë ose dhe planin e mbjelljes të fidanishtes (sipas specieve dhe kombinimeve të shartuara, varieteti i mbishartesës dhe nënshartesës);

- të dhënat për metodat e prodhimit të materialeve të shumëzimit dhe fidanëve të bimëve zbukuruese, për materialet e shumëzimit të përdorura për prodhimin e fidanëve zbukurues dhe regjistrat e ekzaminimeve të kryera dhe masat e zbatuara, duke pasur parasysh, në veçanti, kontrollin dhe mbikëqyrjen e organizmave të dëmshëm e të sëmundjeve;

- të dhënat mbi përshtatshmërinë e tokës për çdo fushë të fidanishtes.

iii) në lidhje me etiketat: dy kopje të modelit të etiketës që furnizuesi propozon të lëshojë për materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve zbukuruese, me përmbajtje sipas pikës 4, të aneksit 3, bashkëlidhur këtij vendimi;

Shënim. Deklaroj se jam i informuar për detyrimet e furnizuesit që lëshon etiketat dhe dokumentet e tjera të furnizuesit, në përputhje me ligjin për materialin mbjellës dhe me këtë vendim.

Kërkuuesi

(emri e mbiemri i furnizuesit ose i përfaqësuesit të tij)
firma e vula

_____, më _____ 201_

E vlefshme deri më 30 prill të një viti më pas.



ANEKSI 4

Model 2

Organi certifikues _____

Nr. i serisë _____

CERTIFIKATË ZYRTARE
për bllokun mëmë ☐ dhe/ose për parcelën e farës ☐ të bimëve zbukuruese

Lëshuar furnizuesit: (emri e mbiemri) _____, (emërtimi i subjektit) _____,

Adresa: e vendbanimit _____,

Vendndodhja e aktivitetit: _____

Kodi i furnizuesit: _____

Bazuar në mbikëqyrjen e kryer nga autoriteti certifikues në datën, _____, sipas ligjit nr. 10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, pasi është konstatuar se përmbushen kërkesat e përcaktuara,

Certifikon bllokun mëmë ☐, **parcelën e farës** ☐, që vijon:

a) blloku i mëmë ☐, **parcela e farës** ☐, është ngritur në ngastrën me nr. pasurie _____, në zonën kadastrale nr. _____, në vendin e quajtur _____, fshati _____, komuna _____, rrethi _____ qarku _____, me sipërfaqe _____ m² dhe me _____ rrënjë bimë mëmë gjithsej.

Të dhënat për mbjelljen e bllokut mëmë ☐ **dhe/ose parcela e farës** ☐, sipas specieve, varieteteve dhe, për nënshartesat, dhe hibrideve ndërmjet specieve, janë si vijon:

Nr.	Speciet, varietetet dhe/ose, për nënshartesat, hibridet ndërmjet specieve	Sipërfaqja m ²	Numri i bimëve gjithsej rrënjë	Sipas destinacionit, rrënjë							
				Për sytha për shartim	Për kalema për shartim	Për kalema për rrënjëzim	Për fundakë Copë	Për kamza për rrënjëzim	Për lastunja	Për fara	Për copa për rrënjëzim
	Gjithsej										
1.	Specia.....										
	Varieteti.....										

Bashkëngjitur janë dokumentet e plotësuar nga personi i ngarkuar nga autoriteti i certifikimit për të mbikëqyrur plotësimin e kërkesave për certifikim në lidhje me planin e prodhimit të paraqitur nga furnizuesi.

Certifikuesi

Emri, mbiemri e firma Vula

Lëshuar më _____ 201_

E vlefshme deri më 30 prill të një viti më pas.



ANEKSI 4

Model 2/1

Organi certifikues _____

Akt verifikimi

Për plotësimin e kërkesave për certifikim nga blloku mëmë ☐ dhe/ose nga parcela e farës ☐

Nga verifikimi i kryer për gjendjen në terren dhe nga mbikëqyrja e dokumentacionit përkatës të mbajtur në datën _____, rezulton si vijon:

Nr.	Kërkesat që duhet të plotësohen për t'u certifikuar	Plotësuar Po ose Jo	Nëse Jo: Afati kur duhet të plotësohet (nëse është e mundur)	Vërejtje

Si përfundim: _____

Personi i ngarkuar nga organi certifikues

Furnizuesi

(emri e mbiemri, firma)_____
(emri e mbiemri, firma)



ANEKSI 4

Model 3

Organi certifikues _____

Nr. i serisë _____

CERTIFIKATË ZYRTARE

për fidanishten

Lëshuar furnizuesit: (emri e mbiemri) _____, (emërtimi i objektit) _____
 adresa: e vendbanimit _____,
 vendndodhja e aktivitetit: _____
 kodi i furnizuesit: _____

Bazuar në mbikëqyrjen e kryer nga autoriteti certifikues në datën _____, sipas ligjit nr. 10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, pasi është konstatuar se përmbushen kërkesat e përcaktuara,

Certifikon fidanishten që vijon:

a) fidanishtja e materialeve të shumëzimit dhe fidanëve zbukurues është ngritur në ngastrat me nr. pasurie _____, në zonën kadastrale nr. _____, në vendin e quajtur _____, fshati _____, komuna _____, rrethi _____ qarku _____, me sipërfaqe _____ m².

Të dhëna për fidanishten

Nr.	Speciet, varietetet dhe/ose, për nënshartesa, filizat sipas specieve dhe hibridet ndërmjet specieve	Sipërfaqja gjithsej m ²	Nga kjo:		Parashikohet të prodhohen për tregtim, për vitin në vijim, rrënjë				
			Për nënshartesa (farishte, vijë fidanishte, copa për rrënjëzim etj.) m ²	Për fidanë (nga shartesa etj. deri te fidanët për shkullje) m ²	Fidanë	Materiale shumëzimi			
	Gjithsej								
1.	Specia.....								
	Varieteti.....								

Bashkëngjitur janë dokumentet e plotësuar nga personi i ngarkuar nga autoriteti i certifikimit për të mbikëqyrur plotësimin e kërkesave për certifikim në lidhje me planin e prodhimit të paraqitur nga furnizuesi.

Certifikuesi

(emri, mbiemri e firma vula)

Lëshuar më _____ 201_

E vlefshme deri më 30 prill të një viti më pas.



ANEKSI 4

Model 3/1

Organi certifikues _____

Akt verifikimi
Për plotësimin e kërkesave për certifikim të fidanishtes

Nga verifikimi i kryer për gjendjen në terren dhe nga mbikëqyrja e dokumentacionit përkatës të mbajtur në datën _____ rezulton si vijon:

Nr.		Kërkesat që duhet të plotësohen për t'u certifikuar	Plotësuar Po ose Jo	Nëse Jo: Afati (nëse është e mundur) kur duhet të plotësohet	Vërejtje

Si përfundim: _____

Personi i ngarkuar nga organi certifikues

Furnizuesi

(emri e mbiemri, firma)_____
(emri e mbiemri, firma)

_____, më _____



ANEKSI 4

Model 4

Organi certifikues _____

Nr. i serisë _____

AUTORIZIM

për nxjerrjen e etiketave të furnizuesit dhe certifikatën e origjinës për materialet e shumëzimit dhe fidanët zbukurues të certifikuar

Lëshuar furnizuesit: (emri e mbiemri) _____, (emërtimi i objektit) _____
 adresa e vendbanimit: _____,
 vendndodhja e aktivitetit: _____
 kodi i furnizuesit: _____.

Bazuar në mbikëqyrjen e kryer nga autoriteti certifikues, sipas ligjit nr. 10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, në certifikatën zyrtare të bllokut mëmë me nr. serie _____, lëshuar më _____201__ dhe në certifikatën zyrtare të fidanishtes me nr. serie _____, lëshuar më _____201__ , pasi është konstatuar se përmbushen kërkesat e përcaktuara,

A u t o r i z o n,

1. Nxjerrjen e etiketave të furnizuesit për materialet e shumëzimit dhe fidanët e certifikuar, si dhe të certifikatave të origjinës që vijojnë:

2. Sasia dhe numri serial i etiketave që autorizohen janë si më poshtë vijon:

Nr.	Emërtimi i llojeve të materialeve të shumëzimit sipas specieve	Varieteti ose sipas rastit për nënshartesat hibridi	Sasia e prodhuar gjithsej copë	Numri i lotit	Etiketat	
					Gjithsej copë	Nr. serial nga _____ deri _____

Bashkëngjitur këtij autorizimi janë modelet e miratuara të etiketës dhe certifikatës së furnizuesit për materialet e shumëzimit.

Certifikuesi

 (emri, mbiemri e firma vula)

Lëshuar më _____201__

E vlefshme deri më 30 prill të një viti më pas



ANEKSI 4

Model 5

CERTIFIKATË ORIGJINE

(nxirret dhe plotësohet nga furnizuesi dhe ka vlerë pasi nënshkruhet nga certifikuesi)

1. Dërguesi: _____ Emër e mbiemër Adresa: _____ Adresa e vendndodhjes së aktivitetit (NIPT ose Kodi Fiskal _____)	3. REPUBLIKA E SHQIPËRISË
2. Marrësi: Emër e mbiemër _____ Emërtimi i subjektit _____ Adresa e plotë: _____ _____	4. Vendndodhja e prodhuesit: (adresa e plotë)
4. Informacion në lidhje me transportin:	5. Vërejtje (shënim):

6. Lista dhe sasia e materialeve të shumëzimit ose dhe fidanëve zbukurues që dërgohen.

Nr.	Lloji i materialeve të shumëzimit dhe specia	Varieteti ose, sipas rastit për nënshartesat hibridi	Kategoria	njësia	Sasia	Sasia e paketimeve sipas llojit të paketimit			Nr. i lotit	Numrat serialë të etiketave
						Kuti	Tufa			

Shënim. Kur lista është e gjatë bëhet një tabelë si kjo dhe i bashkëngjitet certifikatës së origjinës.
 Përdoruesve finalë të materialeve të shumëzimit dhe fidanëve të bimëve zbukuruese, përveç dokumentit të fletëdaljes i bashkëngjitet dhe një fotokopje e kësaj certifikate të origjinës të vërtetuar e vulosur njësisë me origjinalin nga vetë Furnizuesi (ndoshta furnizuesi është vetëm tregtar).

8. Organi certifikues vërteton se materialet e shumëzimit (farë,) dhe/ose fidanët e bimëve zbukuruese (Begonia,) të listuara më sipër janë me origjinë sipas përshkrimit në kuadratin 3 të kësaj tablele.

Certifikuesi furnizuesi

 (firma e vula) (firma e vula)

 Vendi dhe data e lëshimit, emri, nënshkrimi dhe vula e autoritetit kompetent

**UDHËZIM****Nr. 15, datë 19.7.2016****PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN NR. 19, DATË 1.9.2011,
“PËR MODALITETET E APLIKIMIT TË
PULLAVE TË AKCIZËS DHE PULLAVE
FISKALE NË PRODUKTET E DUHANIT,
BIRRËS DHE ALKOOLIT”, TË
NDRYSHUAR**

Bazuar në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 40, 41, 42 dhe 108 të ligjit nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar nenet 48/1; 50/1; 51; 70 dhe 71 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 612/2012, “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat”, të ndryshuar”, ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 19, datë 1.9.2011, “Për modalitetet e aplikimit të pullave të akcizës dhe pullave fiskale në produktet e duhanit, birrës dhe alkoolit”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

1. Baza ligjore ndryshohet sipas përmbajtjes së mëposhtme:

“Bazuar në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 40, 41, 42 dhe 108 të ligjit nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar nenet 48/1; 50/1; 51; 70 dhe 71 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 612/2012, “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat”, të ndryshuar”.

2. Në nënpikën 3.1 të pikës 3, pas përkufizimit “Sistemi qendror i monitorimit të gjurmimeve dhe shenjave” shtohen përkufizimet me përmbajtjen e mëposhtme:

“Depozitues i miratuar” është çdo person fizik apo juridik i autorizuar nga autoritetet doganore sipas përcaktimeve të ligjit 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Statusin e “depozituesit të miratuar” e mban edhe furnitori i pullave të akcizës në përputhje me përcaktimet e nenit 50/1, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 612, datë 5.9.2012, “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat”, të ndryshuar.

“Magazinë fiskale stokimi” është një ambient sipas përcaktimeve të ligjit të akcizës, ku priten, mbahen ose të dërgohen produkte të akcizës.

Në magazinat fiskale të stokimit mund të kryhet edhe vendosja e pullave të akcizës sipas përcaktimeve të nenit 48/1, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 612, datë 5.9.2012, “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat”, të ndryshuar”.

3. Në pikën 4, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

a) Fjalja e katërt e nënpikës 4.1, ndryshohet sipas përmbajtjes së mëposhtme:

“Pullat e akcizës për birrën (prodhuesit e vegjël dhe birrat e importuara) do të vendosen përkatësisht te tapa (për shishet) dhe në fund ose në faqen anësore (për kanoçet).

b) Përpara paragrafit të fundit të pikës 4.1 shtohet paragrafi si më poshtë:

“Pullat e akcizës për produktin “cider” (të prodhuar dhe importuar) do të vendosen përkatësisht mbi tapa (për shishet me tape si ajo e birrës dhe për shishet me tapë në formë kërpudhe) dhe në fund ose në faqen anësore (për kanoçet).

Pullat e akcizës për fuçitë e produktit “cider” do të vendosen te prodhimet përkatëse mbi tapën e kontejnerit përkatës në mënyrë të tillë që të griset kur të hapet.

4. Në nënpikën 5.2, të pikës 5, bëhen ndryshimet dhe shtesat si vijon:

a) Në fund të fjalisë së nënndarjes “i”, të shkronjës “a”, shtohet fjalia me përmbajtjen e mëposhtme:

“Importuesit dorëzojnë paraprakisht tek autoriteti, certifikatën e garancisë për mbulimin e riskut të detyrimeve të akcizës gjatë importimit të produkteve të akcizës, për sasitë e pullave të akcizës që kanë porositur apo dhe që parashikojnë të porositen.”.

b) Në shkronjën “b” në fund të saj, shtohet paragrafi si më poshtë vijon:

“Nga data e daljes, afati i qëndrimit të pullave jashtë Republikës së Shqipërisë, është një vit kalendarik. Ky afat mund të shtyhet nga Autoriteti me kërkesë të arsyetuar të Importuesit. Në rast se nuk bëhet një kërkesë e tillë apo kërkesa refuzohet nga autoriteti, pullat duhet të kthehen nga Importuesi, brenda 45 ditësh kalendarike nga përfundimi i afatit njëvjeçar dhe t’i nënshtrohen procedurës së shkatërrimit si pulla të papërdorura. Në rast të moskthimit të pullave në afatin e përcaktuar, autoriteti procedon me prekjën e garancisë të depozituar për këtë qëllim.



c) Në shkronjën “e” pas fjalisë: “Importuesi ka të drejtën të jetë i pranishëm kur pullat e akcizës të paketohen dhe ngarkohen për t’u dërguar tek agjenti i dërgesës”, shtohet fjalia: “Lëvizja e pullave të akcizës nga marrësi te furnitori bëhet sipas procedurave doganore standarde të përcaktuara të eksportit”.

ç) Pas shkronjës “h” shtohen shkronjat “j” dhe “k” me përmbajtjen si më poshtë:

“j) Për furnizimin me pulla fiskale të depozituesve të miratuar (stokues) që importojnë produkte akcize pa pullë fiskale me qëllim vendosjen e pullës sipas ligjit për akcizën, do të procedohet sipas së njëjtës procedurë që ndiqet për depozituesit e miratuar prodhues/përpunues. Lëvizja e pullave të akcizës nga furnitori te depozituesi i miratuar, do të bëhet sipas procedurave doganore të përcaktuara me DSHA.

k) Miratimi i porosisë së pullave të akcizës u refuzohet importuesve nga autoriteti, kur porositësi nuk ka plotësuar kriterin e garantimit të detyrimit të akcizës sipas sasisë së pullave të porositura ose kur kjo shumë e garantuar nuk e mbulon të gjithë detyrimin e akcizës që i përgjigjet sasisë së pullave të porositura. Brenda 2 ditëve punë nga marrja e porosisë nga prodhuesi/importuesi, autoriteti duhet të njoftojë furnitorin me anë të Sistemit Qendror të Monitorimit të Gjurmëve dhe Shenjave, që kjo porosi është refuzuar.

i) Kur porositësi është shpallur debitor me vendim gjyqësor të formës së prerë apo kur ndaj tij është lëshuar urdhri i ekzekutimit nga gjykata lidhur me titullin ekzekutiv për rikuperimin me forcë të borxhit të akcizës nga vetë autoriteti, miratimi i porosisë së pullave, kryhet vetëm në rastet e parapagimit të detyrimeve të akcizës në çastin e porositjes së pullave fiskale, sipas përcaktimit të pikës 4, të nenit 40, të ligjit nr. 61/2012, “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shoqëruar me një kërkesë me Degën Doganore ku është shpallur debitor.

Në rast të moskryerjes së parapagimit porositësit i refuzohet furnizimi me pullë akcizë. Brenda 2 ditëve punë nga marrja e porosisë nga prodhuesi/importuesi, autoriteti duhet të njoftojë furnitorin me anë të Sistemit Qendror të Monitorimit të Gjurmëve dhe Shenjave, që kjo porosi është refuzuar. Në të tilla raste, autoriteti mund të kyçë aksesin e prodhuesit si porositës, në

Sistemin Qendror të Monitorimit të Gjurmëve dhe Shenjave;

ii) Në rast se një sasi pullash akcize, në njësi të plota paketimi, e porositur nga importuesi, që i është dërguar marrësit (prodhuesit të huaj) nga furnitori i pullave të akcizës, por për shkak të ndryshimeve në marrëdhëniet kontraktore mes marrësit dhe importuesit apo për shkak të mungesës së produktit, nevojitet që këto pulla të dërgohen te marrësi (prodhuesi) i ri, importuesi i paraqet kërkesë me shkrim autoritetit që kjo sasi pullash të transferohet/dërgohet në adresë të një marrësi tjetër. Kërkesës i bashkëngjitet kopja e kontratës së furnizimit me marrësin e ri (prodhuesin e ri të huaj).

Pas aprovimit nga autoriteti doganor, furnitori mundëson:

- ndryshimin në bazën e të dhënave elektronike në Sistemin e Gjurmimit SicpaTrace, lidhur me furnitorin përfundimtar (apo prodhuesin e huaj përfundimtar) të dërgesës në rastin kur sasia e pullave që do të transferohet i përket një porosie të paprekur (të plotë). Kur porosia është e prekur, pra është hequr një sasi pullash nga porosia e plotë, duhet që pullat detyrimisht të kthehen te furnitori, të skanohen dhe më pas të ridërgohen në destinacionin e ri.

- pasqyrimin e të dhënave në sistemin elektronik *online*, me qëllim rakordimin e pullave të porositura, sipas porosisë me nr. ID;

Furnitori njofton autoritetin në rrugë zyrtare në lidhje me ndryshimet dhe pasqyrimin në sistemin e të dhënave të porositësit me furnitorin përfundimtar (apo prodhuesin e huaj përfundimtar); kostot e reja të transportit të pullave nga njëri marrës te tjetri përballohen nga vetë importuesi.”.

d) Numeracioni i shkronjës ekzistuese “j” ndryshohet në “l” dhe përmbajtja e saj ndryshohet si më poshtë vijon:

“l) Në rast të ndonjë mospranimi të pullave të akcizës nga marrësi, agjenti i dërgesës duhet t’ia kthejë të gjithë dërgesën furnitorit. Lëvizja e pullave të akcizës nga marrësi te furnitori bëhet sipas procedurave doganore standarde të përcaktuara. Tarifat e transportit do të paguhën nga furnitori, por nëse papranueshmëria e dorëzimit shkaktohet nga informacioni i gabuar i dhënë nga importuesi, furnitori gëzon të drejtën të faturojë importuesin për këto kosto të tepërta të transportit. Furnitori



duhet ta informojë menjëherë autoritetin se një “dërgesë e pranuar” është kthyer te furnitori. Asnjë shënim krediti nuk do t’i jepet importuesit shqiptar. Pullat e kthyer ose dërgohen në një destinacion të ri të miratuar nga autoritetet doganore ose shkatërrohen nën prezencë doganore sipas rasteve dhe procedurave të mëposhtme.

Në rast të identifikimit të defekteve të produktit nga marrësi, ky i fundit duhet të informojë furnitorin me shkrim se janë identifikuar pulla akcize me defekt. Referencat dhe detajet për pullat e akcizës, rrotën dhe sasinë duhet të përmenden qartësisht. Foto ose shembuj të pjesëve me defekte mund të kërkojnë nga furnitori. Furnitori duhet t’i japë marrësit një autorizim të kthimit për pjesët me defekte në njësi të plota paketimi. Pas kësaj marrësi duhet të përdorë agjentin e dërgesës së furnitorit për kthimin e mallrave. Furnitori duhet të informojë menjëherë autoritetin nëse një dërgesë me defekte është kthyer te magazina e tij. Lëvizja e pullave të akcizës nga marrësi te furnitori bëhet sipas procedurave doganore standarde të përcaktuara.

Pas kontrollit të pullës së akcizës, nëse duket se ka një problem me cilësinë, furnitori do të angazhohet për ta zëvendësuar pa pagesë apo tarifë sasinë me defekt dhe ta ridërgojë te marrësi. Lëvizja e pullave të akcizës nga marrësi te furnitori bëhet sipas procedurave doganore standarde të përcaktuara. Veprimet e lartpërmendura me pullat duhet të regjistrohen nga furnitori në Sistemin Qendror të Monitorimit të Gjurmëve dhe Shenjave. Pullat me defekte të kthyer, shkatërrohen nën prezencë doganore.

Në rastet kur sasia e pullave të akcizës është prishur ose bëhet e papërdorshme përpara se ato të ngjiten ose gjatë procesit të ngjitjes, kur ky veprim bëhet në mënyrë automatike, agjenti i dërgesës duhet t’ia kthejë dërgesën importuesit. Lëvizja e pullave të akcizës të dëmtuara nga marrësi te furnitori bëhet sipas procedurave doganore standarde të përcaktuara. Dega doganore ku ka mbërritur sasia e pullave mund t’i kërkojë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave apo importuesit dokumente vërtetuese të porosisë së pullave, (nr. ID, datë porosisë, nr. R dhe datë e DAV-së, eksporti), blerjes dhe dërgimit të sasisë së pullave në fjalë nga furnitori te marrësi. Pullat e dëmtuara apo të papërdorshme i nënshtrohen procesit të inventarizimit dhe të asgjësimit fizik,

nën mbikëqyrjen e autoritetit, të përfaqësuesit të autoritetit tatimor dhe të furnitorit. Asgjësimi kryhet në ambientet e caktuara nga autoriteti sipas procedurës së përcaktuar në shtojcën 13 të këtij udhëzimi.

Në rast se importuesi kërkon rimbursim të akcizës së parapaguar për pullat e akcizës për rastet e parashikuara në nenin 40 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 612/2012, “Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat”, do të zbatohen dispozitat e nenit 41 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 612/2012. Pullat e akcizës së shpërdoruara ose me tepriçë, nuk mund të kthehen te furnitori dhe çmimi i pullës përkatëse të akcizës nuk mund të rimbursohet.”

5. Në pikën 9 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 9.1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“9.1 Importuesit e produkteve të akcizës, për të cilat kërkojnë pulla fiskale, me përjashtim të depozituesve të miratuar që do të importojnë produkte akcizë pa pullë fiskale për shkak se do të bëjnë vendosjen e saj vetë në magazinat e tyre fiskale, do të bien dakord me prodhuesit që prodhojnë produktet e importuara ose çdo të huaj tjetër që shet me shumicë ose stampues, për të vendosur pullat e akcizës në produktet e tyre të importuara.”

b) Në pikën 9.3 togfjalëshi “ose në fund të kanoçeve të birrës” ndryshohet në “ose në fund të kanoçeve të birrës ose në faqen anësore kanoçeve të birrës”.

c) Në pikën 9.3, shtohet një paragraf i dytë me këtë përmbajtje:

“Për produktin cider, pullat e akcizës në formën e pullës me adeziv, duhet të vendosen në majën e tapës së shisheve (për shishe me tapë si ato të birrës) ose duhet të fiksohen në pjesën e sipërme të grykës së shisheve (për shishe me tapë në formë kërpu dhe) ose në fund të kanoçeve, ose në faqen anësore kanoçeve të ciderës në përputhje me kërkesat e dhëna në shtojcën 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

6. Në shtojcën 1, pjesa e fundit “Pozicionimi i shiritave të akcizës në produktet e birrës”, ndryshohet si më poshtë:

“Shiritat e akcizës për birrën do të përdoren në pjesën e sipërme të tapës (për shishe dhe fuçitë e birrës) dhe poshtë ose në faqen anësore (për kanoçet).

Sipërfaqja në të cilën do të vendosen shiritat e akcizës duhet të jetë e thatë dhe pa asnjë kondensim, yndyrë ose substancë vajore.

Për kanoçet, pullat e akcizës duhet të përdoren në qendër të pjesës së fundit të kanoçes (shihni figurën 15) ose në faqen anësore (shihni figurën 15/1).



Figura 15. Aplikimi i shiritit të akcizës në fund të kanoçes

Figura 15.1. Aplikimi i shiritit të akcizës në faqen anësore të kanoçes

Për shishet, pullat e akcizës duhet të përdoren në qendër të pjesës së sipërme (shihni figurën 16: Përdorimi i shiritit të akcizës te shishet.



Figura 16: Aplikimi i shiritit të akcizës për shishet

Për fuçitë, shiritat e akcizës duhet të përdoren përgjatë tapës (shihni figurën 17)



Figura 17. Aplikimi i shiritit të akcizës për fuçitë.”.

7. Në fund të shtojcës 1 shtohet “Pozicionimi i shiritave të akcizës në produktet cider”, me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“Për produktin cider, me shishe si ato të birrës, pulla e akcizës është në formë rumbullake si në figurën 18.

Figura 18. Aplikimi i shiritit të akcizës për produktet cider

Shiriti i pullës për shishet me tapë si ato të birrës

duhet të përdoren në qendër të pjesës së sipërme njëjloj, si dhe për birrën e importit e paraqitur në figurën 16 të udhëzimit.

Sipërfaqja në të cilën do të vendosen shiritat e akcizës duhet të jetë e thatë dhe pa asnjë kondensim, yndyrë ose substancë vajore.

Me qëllim përdorimin korrekt dhe mundësinë për kontroll efektiv të aplikimit të pullave të këtij produkti, për pullat e cider nga koncensionari do të



konfigurohen në sistemin elektronik kode të ndryshme përkatësish për produktet e importuara dhe vendase respektivisht: “cider i importuar” dhe “cider vendi”.

Shiriti i pullës së akcizës për shishet me tape në formë kërpu dhe do të jetë dhe duhet të përdoren sipas përcaktimeve në pikat 2.1 e 2.2 të shtojcës 1, si dhe figurat 6–9 të udhëzimit.

Me qëllim përdorimin korrekt dhe mundësinë për kontroll efektiv të aplikimit të pullave të këtij produkti, për pullat e cider nga koncensionari do të konfigurohet në sistemin elektronik një kod i ri i dedikuar: “CIDER. Pullë e gjatë/shirit” sipas përshtatimit që do të përcaktohet nga autoriteti doganor në bashkëpunim me koncensionarin dhe personalizimi do të jetë në nivel kodimi: “import” ose jo, dhe volumi përkatës.

Për kanoçet, pullat e akcizës duhet të përdoren në qendër të pjesës së fundit të kanoçes ose në faqen anësore, si dhe për birrën (shihni figurën 15 dhe figura 15/1)

Për fuqitë e ciderës, shiritat e akcizës do të jenë dhe do të aplikohen njëloj si për fuqitë e birrës sipas figurës 17.

Me qëllim përdorimin korrekt dhe mundësinë për kontroll efektiv të aplikimit të pullave të këtij produkti, për pullat e ciderës nga koncensionari do të konfigurohet në sistemin elektronik një kod i ri i dedikuar: “CIDER fuçi” dhe personalizimi do të jetë në kodimi: “import” ose jo, dhe volumi përkatës.

8. Në tabelën 2: Sasitë minimale të porositjes së pullave të akcizës/fiskale dhe intervalet e rritjes mbi sasinë minimale, shtohet rreshti si më poshtë:

Lloji i produktit	Sasia minimale e porosisë	Intervalet e rritjes
Cider	1000	1000

Çmimi (duke përfshirë TVSH-në dhe çdo taksë tjetër apo detyrime pulle të aplikueshme, sipas ligjit shqiptar) për pullat e produktit “cider” është i njëjtë me çmimin e pullave të alkoolit sipas shtojcës nr. 2 të ligjit 61/2012.

9. Ky udhëzim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Ahmetaj

SHTOJCA 13

PROCEDURA E SHKATËRRIMIT TË PULLAVE TË PAPËRDORURA/TË DËMTUARA/ME DEFEKTE

Për sasinë e pullave për të cilat kërkohet shkatërrimi/asgjësimi fizik, subjekti me anë të kërkesës tip që i bashkëlidhet udhëzimit, njofton Departamentin e Akcizës në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Degën Doganore Mbikëqyrëse dhe drejtorinë rajonale tatimore ku është regjistruar subjekti. Pas dakordësimit dhe rakordimit midis autoriteteve doganore dhe tatimore, caktohet data dhe ambienti ku do të kryhet shkatërrimi/asgjësimi fizik i pullave fiskale.

Shkatërrimi kryhet zakonisht dy herë në vit, në muajt qershor dhe dhjetor.

Për kryerjen e shkatërrimit ngrihet një komision i posaçëm me përbërjen e mëposhtme:

- një përfaqësues nga Departamenti i Akcizës në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave;
- një përfaqësues nga dega doganore mbikëqyrëse;
- një përfaqësues nga drejtoria rajonale tatimore përkatëse;
- një përfaqësues i subjektit.

Komisioni paraprakisht kryen numërimin e pullave fiskale që do të shkatërrohen, bën skanimin e tyre me anë të aparatit SICPAMOBILE për të vërtetuar që këto pulla i përkasin subjektit kërkues dhe me pas kryhet procesi i shkatërrimit të pullave (me grirje ose me djegie) në ambientet e përcaktuara për shkatërrim.

Për gjithë procesin e procedurës së shkatërrimit mbahet procesverbali përkatës në të cilin pasqyrohen të dhëna mbi sasinë e pullave të numëruara, të shkatërruara për secilin format, sasinë e pullave të shkatërruara në total. Procesverbali pasqyron edhe faktin e skanimit të pullave me aparatin SICPAMOBILE dhe rezultatet e skanimit.

Ky procesverbal, mbahet në katër kopje dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit që kanë qenë prezentë gjatë procesit të shkatërrimit.

Një kopje e këtij procesverbal i dërgohet përfaqësuesit të subjektit, një kopje i dërgohet autoritetit tatimor dhe dy kopjet e tjera administrohen nga autoriteti doganor.



KËRKESË

Drejtuar: Departamentit të Akcizës, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave
Degës Doganore Mbikëqyrëse

Drejtorisë Rajonale Tatimore, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Lënda: Për shkatërrimin e Pullave të dëmtuara apo të papërdorura

I	Të dhëna mbi subjektin		
	Subjekti:		
	NIPT:		
	Adresa:		
II	Të dhëna mbi pronësinë e pullave që do të shkatërrohen		
	ID-ja e porosisë:		
	Data e porosisë:		
	Nr. R DAV eksporti:		
	Data e DAV-së eksporti:		
	Nr. faturë tatimore shitjeje:		
	Data e faturës tatimore të shitjes:		
III	Të dhëna mbi formatin e pullave	Lloji i produktit të akcizës	Sasia e pullave në copë
		Total, pulla për t'u shkatërruar/asgjësuar (sasia totale në copë)	
IV	Arsyet e shkatërrimit/asgjësimit fizik		

Data: _____ emri/nënshkrimi i përfaqësuesit të operatorit

VENDIM

Nr. 112, datë 8.7.2016

**PËR PËRCAKTIMIN E TË
LICENCUARIT TË NGARKUAR ME
DETYRIMIN E SHËRBIMIT UNIVERSAL
PËR TREGUN E ENERGJISË
ELEKTRIKE DHE PËRCAKTIMIN E
KUSHTEVE PËR USHTRIMIN E
DETYRIMIT TË SHËRBIMIT
UNIVERSAL**

Në mbështetje të neneve 16; 19; 47; 83 dhe 85 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të

Faqe | 11178

shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” dhe nenit 26 të rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 8.7.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike mbi përcaktimin e të licencuarit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal, si dhe kushtet për ushtrimin e detyrimit të shërbimit universal,

konstatoi se:



- ERE, në mbështetje të neneve 19, germa “d” dhe 83 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, vendos ndaj të licencuarve detyrimin e shërbimit universal të furnizimit, në përputhje me parashikimet e neneve 47 dhe 85 të ligjit, sipas kushteve të përcaktuara nga ERE.

- Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 244, datë 30.3.2016, ka miratuar “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, përcakton në nenet 2 dhe 4: “Detyrimi i shërbimit publik ndaj një të licencuari vendoset nga ERE”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Detyrimi i shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike i vendoset shoqërisë OSHEE sh.a./FSHU, sipas përcaktimeve të nenit 83, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe kushteve të përcaktuara në këtë vendim.

2. Kushtet për ushtrimin e detyrimit të shërbimit universal për tregun e energjisë elektrike bashkëlidhur këtij vendimi përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet për të siguruar përmbushjen e detyrimit të shërbimit universal të energjisë elektrike.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 113, datë 8.7.2016

MBI MIRATIMIN E RREGULLORES PËR NDRYSHIMIN E FURNIZUESIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 88, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenit 25 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.7.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike të ERE-s, në lidhje me miratimin e “Rregullores për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- ERE është organi kompetent për hartimin dhe miratimin e kësaj rregulloreje.

- Njehsimi i praktikës së rregullave për ndryshimin e furnizuesit në sektorin e energjisë elektrike, krijon lehtësira për të gjithë operatorët e tregut.

- Rregullorja e ndryshimit të furnizuesit përcakton kushtet, të drejtat dhe detyrimet e furnizuesve dhe klientëve të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike (bashkëlidhur këtij vendimi).

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

**RREGULLORE****MBI NDRYSHIMIN E FURNIZUESIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE****PJESA I****DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****Neni 1****Qëllimi**

Këto rregulla do të normojnë kushtet dhe procedurat për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike, të cilët furnizojnë klientin fundor sipas kontratës së furnizimit, si dhe përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e furnizuesit, klientëve dhe të operatorit të sistemit në kuadër të procedurës së ndryshimit të furnizuesit.

Neni 2**Objekti**

1. Objekti i kësaj rregulloreje janë vendosja e rregullave për palët në kontratë, për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike dhe garantimi i së drejtës së klientit për të kërkuar ndryshimin e furnizuesit.

Neni 3**Baza ligjore**

1. Kjo rregullore mbështet në:

- Ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenet 79; 80; 81; 82; 88.
- Ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.
- “Rregulloren e organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.5.2016.
- Ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”.
- Ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
- Kodin e Matjes.
- Kodin e Shpërndarjes.
- Kodin e Transmetimit.

Neni 4**Përkufizimet**

Përkufizimet pjesë e kësaj rregulloreje kanë kuptimin si më poshtë:

1. “Ligji i energjisë” nënkuptohet ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

2. “Enti rregullator i energjisë” ose “ERE” është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me ligjin “Për sektorin e energjisë elektrike”.

3. “I licencuar” është një person i pajisur me licencë për të zhvilluar aktivitetet në sektorin e energjisë elektrike, në përputhje me dispozitat e ligjit për energjinë.

4. “Pika e shpërndarjes”, pika e përcaktuar si pika e shpërndarjes/furnizimit nga rregullorja, e cila normon kushtet e përgjithshme të furnizimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.

5. “Furnizues i ri”, furnizuesi me të cilin klienti dëshiron të nënshkruajë një kontratë furnizimi në fillim të procedurës për ndryshimin e furnizuesit.

6. “Operator i sistemit” është një person juridik, përgjegjës për operimin e sigurt, të besueshëm dhe të efektshëm të rrjetit të shpërndarjes/transmetimit, duke siguruar mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, të shtrirë në një zonë të caktuar dhe, kur është e aplikueshme, lidhjet e tij me sisteme të tjera për të siguruar aftësi afatgjatë të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë, në harmoni me mjedisin dhe eficiencën e energjisë.

7. “Furnizues aktual”, furnizuesi i cili furnizon klientin në fillim të procedurës së ndryshimit të furnizuesit.

8. “Furnizim” është shitja, përfshirë rishitjen e energjisë elektrike te klientët.

9. “Furnizues” është një person e licencuar për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit.

10. “Furnizues i mundësisë së fundit” është një furnizues i caktuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji, i cili ofron për një periudhë të kufizuar kohe shërbimin e furnizimit në kushte të rregulluara ndaj klientëve, të cilët nuk kanë mundur të kontraktojnë vetë një furnizues ose kanë humbur furnizuesin e tyre.

11. “Klient” është një klient shumice ose fundor i energjisë elektrike.

12. “Klient fundor” është një klient që blen energji elektrike vetëm për përdorim vetjak.

13. “Kodi i shpërndarjes” është tërësia e rregullave teknike, të cilat rregullojnë funksionimin e rrjetit të shpërndarjes, si dhe vendosin kushtet e shërbimit që ofrohen nga operatorët e sistemit të shpërndarjes për përdoruesit e sistemit të shpërndarjes.



14. “Kodi i transmetimit” është tërësia e rregullave teknike, të cilat rregullojnë operimin e sistemit të transmetimit, si dhe përcaktojnë kushtet e shërbimit që ofrohen nga operatori i sistemit të transmetimit ndaj përdoruesve të sistemit të transmetimit, në përputhje me rregullat e ENTSO-e.

15. “Kodi i matjes” është tërësia e normave minimale të detyrueshme për matjen dhe regjistrimin e energjisë elektrike.

16. “Kontrata e furnizimit” është një kontratë për furnizimin me energji elektrike, por që nuk përfshin derivativët e energjisë elektrike.

17. “Ditë” do të thotë ditë kalendarike dhe, në çdo rast që përfundimi i afatit përkon me një ditë pushimi apo festë zyrtare, afati shtyhet në ditën e parë të punës pasardhëse.

Neni 5

Procedura për paraqitjen e kërkesës/aplikimit

1. Ka të drejtë të bëjë kërkesë për ndryshimin e furnizuesit çdo klient i energjisë elektrike me kusht që të ketë ekzekutuar të gjitha detyrimet në raport me furnizuesin e parë.

2. Procedura për ndryshimin e furnizuesit fillon me paraqitjen e një kërkesë dhe dokumentacioni në kuadër të kësaj rregulloreje, do të paraqitet në mënyrë direkte, pranë selive të furnizuesit aktual ose nëpërmjet postës.

3. Së bashku me kërkesën për ndryshim, personi i përcaktuar për pranimin e dokumentacionit do të konfirmojë/vërtetojë marrjen dhe pranimin e aplikimit e tyre.

4. Paraqitja e dokumentacionit do të konsiderohet e vlefshme në datën e pranimit të tij. Pranimi i kërkesës për ndryshimin e furnizuesit do të konsiderohet i vlefshëm në datën kur ai pranohet, sipas afateve të përcaktuara në këtë rregullore.

5. Me pranimin e kërkesës për ndryshimin e furnizuesit nga furnizuesi aktual, klientit i lind e drejta për të aplikuar pranë cilitdo furnizues/furnizuesve të zgjedhur prej tij.

6. Procedura e ndryshimit të furnizuesit nuk mund të tejkalojë afatin 15-ditor, afat i cili fillon nga data e dorëzimit të aplikimit.

7. Klienti, i cili ka nënshkruar një kontratë furnizimi duhet të paraqesë aplikimin, siç parashikohet në paragrafin 1 të këtij neni jo më vonë se 15 ditë përpara periudhës së vlefshme të përfundimit të kontratës në fuqi.

8. Në veçanti, formati duhet të përfshijë:

- të dhënat e shoqërisë tregtare/personit fizik/juridik, selinë/adresën, NUIS/ID) emrin dhe mbiemrin, si dhe të dhënat e klientit kërkuar;
- numrin identifikues të pikës së shpërndarjes/furnizuesit, siç paraqitet në bazën e të dhënave të operatorëve të sistemit;
- fuqinë e aprovuar;
- datën e dorëzimit të aplikimit;
- emri i shoqërisë tregtare të furnizuesit aktual dhe numrin identifikues të kontratës së nënshkruar mes klientit dhe furnizuesit aktual.

Neni 6

Paraqitja e dokumentacionit

1. Mbas paraqitjes së aplikimit siç parashikohet në neni 5, klienti duhet të paraqesë në dy kopje (njëra e noterizuar dhe tjetra fotokopje) dokumentacionin e mëposhtëm:

2. Një vërtetim, të lëshuar nga furnizuesi aktual me qëllimin për të iniciuar procedurat e ndryshimit të furnizuesit, e cila nuk duhet të lëshohet më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së dorëzimit të aplikimit. Nëpërmjet këtij dokumenti, furnizuesi aktual konfirmon se përgjegjësitë financiare të përbashkëta të kontratës së furnizimit, efektive në ditën që është lëshuar dokumenti, janë zgjidhur mes furnizuesit dhe klientit.

3. Pëlqimin e klientit për të përdorur të dhënat personale dhe të dhëna të tjera të përfituara përgjatë procedurës së ndryshimit të furnizuesit, e vlefshme vetëm në funksion të ndryshimit të furnizuesit.

4. Me marrjen e konfirmimit të aplikimit për ndryshim të furnizuesit, furnizuesi i ri do të përcaktojë, gjithashtu, kohëzgjatjen e shqyrtimit të aplikimit për lidhjen e kontratës së re.

5. Furnizuesi ka detyrimin ta bëjë publik formatin e aplikimit dhe t'i sigurojë klientit në çdo rast një të tillë pa pagesë.

6. Nëse furnizuesi i ri e cilëson aplikimin të pakuptueshëm ose jo të plotë brenda periudhës kohore 3-ditore nga pranimi i tij, ai do të ftojë klientin për të korrigjuar mangësitë në të, si dhe të vërë në dijeni klientin mbi pasojat që vijnë si rezultat i mospërbushjes së kushteve të kërkesës.

7. Nëse furnizuesi i ri evidenton se aplikimi është i pavlefshëm do të njoftojë klientin dhe operatorin e sistemit mbi mospërbushjen e kushteve për ndryshimin e furnizuesit.



8. Brenda tri ditëve nga dita e marrjes së deklaratës/kërkesës, furnizuesi aktual ka të drejtën për të paraqitur një ankesë tek operatori i sistemit, nëse konstaton se klienti nuk e plotëson kushtin për ndryshimin e furnizuesit.

9. Nëse furnizuesi aktual nuk paraqet një ankim tek operatori i sistemit, ky i fundit do të informojë klientin dhe furnizuesin e ri mbi mospërmbushjen e kushteve për ndryshimit e furnizuesit.

10. Nëse furnizuesi aktual nuk paraqet një ankim, si më sipër parashikuar, operatori i sistemit do të mundësojë të dhënat e matjes për pikën/pikat e shkëmbimit të klientit - për të cilën procedura është iniciuar me paraqitjen e aplikimit - brenda 7 (shtatë) ditëve nga afati i fundit për paraqitjen e ankimit.

11. Për sa i përket klientit, operatori i sistemit do të paraqesë të dhënat e matjes për pikën e shpërndarjes, në ditën e përfundimit të kontratës.

12. Nëse gjatë procedurës së ndryshimit të furnizuesit dhe deri në ditën e ndryshimit të furnizuesit, operatori i sistemit merr disa aplikime nga furnizues të ndryshëm për të njëjtën pikë/pika shpërndarjeje, për të njëjtin klient, operatori i sistemit do të ftojë klientin brenda 3 ditëve që prej ditës që lajmërimi është paraqitur, në mënyrë që të vendosë se me cilin aplikim do të procedojë duke lajmëruar, gjithashtu, mbi pasojat që rëndojnë në rast mospërmbushjeje të afatit kohor të përcaktuar.

13. Nëse, përgjatë ecurisë së aplikimit të përcjellë si me sipër operatori i sistemit, pasi ka kontrolluar të dhënat dhe *database-n*, dhe nëse evidenton pasaktësi të të dhënave të aplikimit, ai do të informojë furnizuesin brenda 3 ditëve mbi këto pasaktësi. Me marrjen e lajmërimit/njoftimit me shkrim nga operatori i sistemit, furnizuesi i ri do të ftojë klientin për të ndryshuar të dhënat e paraqitura në aplikim brenda 3 (tri) ditëve nga dita që klienti është ftuar për të ndryshuar të dhënat e vendosura në aplikim, duke saktësuar një afat kohor për rishikimin.

14. Nëse klienti rishikon aplikimin brenda afatit të përcaktuar, furnizuesi i ri do t'i përcjellë aplikimin e rishikuar operatorit të sistemit brenda 3 ditëve prej marrjes së tij, ndërsa operatori i sistemit do të veprojë sipas nenit 6.

15. Nëse klienti nuk rishikon të dhënat brenda afatit të përcaktuar edhe pse ai është ftuar për të vepruar në këtë mënyrë, furnizuesi i ri do të njoftojë klientin mbi mospërmbushjen e kushteve

për ndryshimin e furnizuesit brenda afatit dhe jo më shumë se tri ditë nga paraqitja e aplikimit.

16. Të dhënat e matjes të pikës/pikave të shpërndarjes, të cilat janë dhënë nga operatori i sistemit siç parashikohet në këtë nen, duhet të përfshijnë datën së cilës i referohen, datë e cila konsiderohet të jetë dita e ndërrimit të furnizuesit.

17. Në ditën që furnizuesi është ndryshuar, kontrata e furnizimit e nënshkruar mes klientit dhe furnizuesit të ri do të hyjë në fuqi dhe kontrata mes klientit dhe furnizuesit aktual do të pushojë efektet juridike. Pika e shpërndarjes ekzistuese do t'i transferohet furnizuesit të ri.

Neni 7

Procedura e ndërrimit të furnizuesit në rastet e ndërrimit të furnizuesi i mundësisë së fundit

1. Në rast ndryshimi të furnizuesi i mundësisë së fundit, për shkak të falimentimit apo paaftësisë pague, pezullimit apo heqjes së licencës së furnizuesit aktual apo kur klienti nuk ka arritur të gjejë një furnizues në treg dita e ndryshimit të furnizuesit do të konsiderohet dita kur pasojat ligjore që kanë çuar në fillimin e procedurave të falimentit dhe procedurat e likuidimit dhe rastet e tjera të përcaktuara në këtë nen, kanë hyrë në fuqi.

2. Furnizuesi aktual është i detyruar të informojë klientët, operatorët e sistemit dhe furnizuesin e mundësisë së fundit në ditën që pasojat ligjore të falimentit dhe likuidimit apo rrethanave të tjera kanë hyrë në fuqi, pa asnjë vonesë, në harkun kohor jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, duke filluar nga dita që furnizuesi aktual është i vetëdijshëm për paaftësinë e tij për të kryer aktivitetin e furnizimit.

3. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dorëzimi i lajmërimit të furnizuesit aktual, operatori i sistemit duhet të paraqesë të dhënat e matjes për pikën/pikat e shpërndarjes dhe t'ia përcjellë ato klientit, furnizuesit aktual dhe furnizuesit të mundësisë së fundit.

4. Në rast se licenca e furnizuesit aktual përfundon, është pezulluar apo hequr, pa asnjë vonesë, në harkun kohor të 15 ditëve, nga data e përfundimit të vlefshmërisë së licencës ose nga data e hyrjes në fuqi të vendimit për heqjen ose pezullimin e licencës ERE do të informojë të gjithë operatorët e sistemit, dhe furnizuesin e mundësisë



së fundit mbi heqjen apo pezullimin e licencës së furnizimit.

5. Operatori i sistemit duhet të paraqesë të dhënat matjes të pikës/pikave të shpërndarjes/furnizimit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dorëzimi i njoftimit të ERE-s dhe të informojë klientët apo furnizuesin të cilit i ka përfunduar afati i licencës, shfuqizuar apo revokuar, si dhe furnizuesin e mundësisë së fundit.

6. Klienti i cili gëzon të drejtën për t'u furnizuar sipas mundësisë së fundit, i cili nuk ka gjetur një furnizues pas përfundimit të kontratës së shitjes/furnizimit me furnizuesin e mëparshëm, i lind e drejta për të kërkuar për t'u furnizuar nga furnizuesi i mundësisë së fundit për një periudhë jo më shumë se 60 ditë, afat kohor i cili fillon që nga dita e përfundimit të afatit të kontratës së mëparshme të shfuqizuar.

7. Brenda tri ditëve nga dorëzimi i aplikimit për furnizuesin e mundësisë së fundit, ky i fundit duhet të lidhë kontratën e furnizimit me klientin, e cila do të hyjë në fuqi dhe do të fillojë të zbatohet ditën që ndryshohet furnizuesi dhe do të informojë operatorin e sistemit brenda tri ditëve.

8. Në çdo rast dhe jo më vonë se 3 (tri) ditë nga dorëzimi i njoftimit me shkrim të furnizuesit të mundësisë së fundit, operatori i sistemit është i detyruar të paraqesë të dhënat e matjes për pikën/pikat e shpërndarjes dhe të informojë furnizuesin e mundësisë së fundit, si dhe klientin.

Neni 8

Të drejtat dhe detyrimet e furnizuesit

1. Një furnizues i energjisë elektrike gëzon të drejtën për të marrë pjesë në procedurën e ndryshimit të furnizuesit në cilësinë e furnizuesit të ri, siç parashikohet në këtë rregullore, vetëm nëse furnizuesi është licencuar dhe reregjistruar në regjistrin e pjesëmarrjeve të tregut të energjisë elektrike të mbajtur nga operatori i tregut, në përputhje me ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike".

2. Furnizuesi i ri i energjisë, pika e shpërndarjes e të cilit është brenda sistemit të transmetimit duhet të sigurojë kapacitete në pikën e daljes nga sistemi i transmetimit me qëllimin e shpërndarjes së energjisë elektrike ndaj klientit të ri.

PJESA II DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 9 Ankimimi

1. Çdo ankesë lidhur me procedurën e ndryshimit të furnizuesit, mund paraqitet në ERE brenda 30 ditëve kalendarike.

2. Ankesa nuk pezullon afatin për ndryshimin e furnizuesit dhe/ose të hyrjes në fuqi të kontratës së re të furnizimit.

Neni 10 Rishikimi dhe ndryshimi i rregullave

Kjo rregullore është objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit të ERE-s.

Neni 11 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi mbas miratimit nga Bordi i ERE-s.

VENDIM Nr. 114, datë 8.7.2016

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR TRAJTIMIN E ANKESAVE TË PARAQITURA NGA KLIENTËT DHE PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE MIDIS TË LICENCUARVE NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE DHE TË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të neneve 16; 20, pika "ë"; neni 24, pika 1 dhe 2 të ligji nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike"; nenit 17, pika "ë"; neni 98, pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 102/2015, "Për gazin natyror" dhe nenit 26 të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s" miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës __.7.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit të ERE-s, në lidhje me miratimin e "Për miratimin e rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror",

konstatoi se:



- ERE është organi kompetent për hartimin dhe miratimin e kësaj rregulloreje.

- Me vendimin nr. 92, datë 9.6.2016, Bordi i ERE-s ka miratuar “Fillimin e procedurave për miratimin e “Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror””.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë “Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

RREGULLORE

PËR TRAJTIMIN E ANKESAVE TË
PARAQITURA NGA KLIENTËT DHE PËR
ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE
MIDIS TË LICENCUARVE, NË SEKTORIN E
ENERGJISË ELEKTRIKE DHE TË GAZIT
NATYROR

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

1.1 Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë kushtet dhe procedurat, për shqyrtimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lindin mes të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe atë të gazit natyror dhe trajtimin e ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror.

1.2 Gjatë shqyrtimit të mosmarrëveshjeve dhe ankesave, ERE në zbatim të kësaj rregullore ka për qëllim:

a) të ofrojë zgjidhje të shpejtë për mosmarrëveshjet dhe ankesat mes të licencuarve në sektorin e energjisë dhe klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror;

b) të sigurojë që të drejtat e të gjitha palëve janë respektuar;

c) të kontribuojë në përmbushjen e të gjithë objektivave rregullatorë në sektorin e energjisë elektrike dhe në sektorin e gazit natyror;

d) të sigurojë funksionimin e strukturave konkurruese të tregut të energjisë dhe integrimin e tregut shqiptar në atë rajonal dhe evropian të energjisë.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore mbështetet në:

- ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” neni 20, germa “ë”; neni 24, pika 1 dhe 2;

- ligjin nr. 102/2015, “Për gazin natyror” neni 16, pika 16; neni 17, pika 1, germa “ë”; neni 98, pika 1 dhe 2;

- ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

- “Rregulloren e organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016;

- ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”;

- ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;

- ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

Neni 3

Objekti

Kategoritë e ankesave dhe të mosmarrëveshjeve, objekt i kësaj rregulloreje janë si më poshtë:

3.1 ERE në zbatim të nenit 24, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenit 98, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” ka autoritetin ligjor:

3.1.1 për të trajtuar ankesat e klientëve ndaj të licencuarve në lidhje me shërbimet e ofruara:

3.1.2 për të zgjidhur mosmarrëveshjet mes të licencuarve në lidhje me ushtrimin e aktivitetit të licencuar.

3.1.3 për të zgjidhur mosmarrëveshjet mes të licencuarit dhe çdo klienti apo përdoruesi të sistemit të shpërndarjes dhe sistemit të transmetimit, me cilësinë e palës së tretë, i cili kërkon akses në rrjet,



3.1.4 Çdo ankesë apo mosmarrëveshje që lidhet me elemente të veprës penale ose për të cilën ka filluar një proces gjyqësor, nuk do të trajtohen nga kjo rregullore.

Neni 4 Përkufizime

Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

4.1 “Ligji i energjisë” nënkuptohet ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”;

4.2 “Ligji i gazit” nënkuptohet ligji nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”;

4.3 “Enti Rregullator i Energjisë” ose “ERE” është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me ligjin “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligjin “Për sektorin e gazit natyror”;

4.4 “I licencuar” është një person i pajisur me licencë për të zhvilluar aktivitet në sektorin e energjisë, në përputhje me dispozitat e ligjit për energjinë dhe ligjit për gazin natyror;

4.5 “Ankues” nënkupton personin fizik/juridik, i cili depoziton një ankesë në ERE për çdo veprim ose mosveprim të një të licencuari, që është në juridiksionin e ERE-s, për aktivitetet e parashikuar në ligjin për energjinë elektrike dhe ligjin për gazin;

4.6 “Palë të treta” nënkupton palë të tjera, të cilat mund të jenë të lidhura me zgjidhjen e mosmarrëveshjes;

4.7 “Mosmarrëveshje” çdo konflikt midis një të licencuari me një ose disa të licencuar të tjerë;

4.8 “Ankesë” çdo kërkesë e parashtruar pranë ERE-s, prej klientëve ndaj të licencuarve, lidhur me shërbimin e ofruar nga i licencuari;

4.9 “Klient” është një klient shumice ose fundor i energjisë elektrike dhe gazit natyror, si dhe çdo subjekt tjetër i gazit natyror që blen gaz natyror;

4.10 “Bordi” është organi vendimmarrës i ERE-s, i emëruar sipas ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligjit nr. 102/2015, “Për gazin natyror”;

4.11 “Interkonektor” është një linjë transmetimi e ndërtuar nga operatori i sistemit të transmetimit ose një palë e tretë, e cila kalon nëpërmjet kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë dhe të një vendi tjetër dhe lidh sistemet kombëtare të transmetimit të të dyja vendeve;

4.12 “Akses i palës së tretë” është e drejta e të gjithë përdoruesve të sistemit për përdorimin e

sistemit të transmetimit, shpërndarjes dhe depozitimit të gazit natyror, bazuar në kushte të përcaktuara e të publikuara, në përputhje me parimet e transparencës e të mosdiskriminimit, kundrejt tarifave të miratuara nga ERE;

4.13 “Linjë interkonjeksioni” është një linjë transmetimi, e cila lidh sistemet e transmetimit ndërmjet dy shteteve.

PJESA E DYTË ROLI DHE PARIMET E ERE-s NË ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE DHE TRAJTIMIN E ANKESAVE

Neni 5 Roli i ERE-s në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe trajtimin e ankesave

5.1 Veprimtaria e ERE-s për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe trajtimin e ankesave është ajo e parashikuar nga legjislacioni në sektorin e energjisë.

5.2 Ky rol i ERE-s lidhet me përcaktimin e termave, kushteve dhe procedurave në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe trajtimin të ankesave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, në mënyrë të tillë që:

5.2.1 Të sigurojë trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues ndaj të gjithë klientëve dhe të licencuarve në sektorin e energjisë, në respekt dhe në përmbushje të të drejtave dhe detyrimeve të tyre në shërbimin e furnizimit me energji elektrike dhe gaz natyror.

5.2.2 Të mbrojë klientët e furnizimit me energji elektrike dhe gaz natyror, përmes procedurës transparente, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe trajtimin të ankesave dhe garantimin e furnizimit me energji elektrike dhe gaz natyror

5.2.3 Të zgjidhë ankesat midis klientëve dhe furnizueseve, si dhe midis të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror.

Neni 6 Parimet e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe ankesave

6.1 Parimi i transparencës.

ERE do të bazohet në parimin e transparencës për trajtimin sa më të drejtë të ankesave dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, që nënkupton publikimin e informacionit lidhur me mosmarrëveshjet të cilat ERE i ka shqyrtuar, si dhe



arsyetimin për arritjen e zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

6.2 Parimi i barazisë

ERE do të bazohet në parimin e barazisë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe trajtimin e ankesave, duke siguruar trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues ndaj të gjithë klientëve dhe të licencuarve të tregut të energjisë në respekt dhe në përmbushje të të drejtave dhe detyrimeve të tyre në shërbimin e furnizimit me energji elektrike dhe gaz natyror.

6.3 Parimi i konfidencialitetit

6.3.1 Në zbatim të nenit 16, pika 4 të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenit 16, pika 15, të ligjit “Për sektorin e gazit natyror”, ERE është e detyruar të publikojë vendimet lidhur me mosmarrëveshjet dhe të marrë parasysh detyrimin për të ruajtur konfidencialitetin dhe sekretin tregtar. Publikimi do të bëhet në faqen e internetit të ERE-s, duke mos përfshirë pjesët që kanë të bëjnë me sekretin tregtar.

6.3.2 Në publikimin e vendimeve të saj, ERE do të mbajë në konsideratë parimin e sekretit tregtar të palëve, konform ligjit “Për shoqëritë tregtare”. Megjithatë, ERE nuk do të pranojë domosdoshmërisht si të mirëqena pohimet e palëve se interesat e tyre do të dëmtoheshin nga publikimi i informacioneve të caktuara. ERE do të japë vendime të qarta dhe të arsyetuara për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, duke treguar procedurën e shqyrtimit të çështjes dhe arsyen pse ka arritur në atë vendim.

6.3.3 Palët duhet të deklarojnë nëse, dhe në çfarë baze, një informacion i caktuar do të klasifikohet si sekret tregtar dhe sensitiv kur ato i ofrojnë informacione ERE-s. Publikimi ose jo i një informacioni të caktuar është një çështje të cilën e vendos ERE.

6.3.4 ERE është e detyruar të respektojë kërkesat për ruajtjen e konfidencialitetin për çdo informacion apo dokument të vënë në dispozicion nga klienti, në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, në lidhje me një ankesë të paraqitur nga ky i fundit.

Neni 7

Informimi

7.1 ERE duhet të sigurojë në mënyrë lehtësisht të disponueshme për klientët, të licencuarit dhe palët e tjera të interesuara, informacionin e

nevojshëm për kushtet, procedurat dhe afatet e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe trajtimit të ankesave.

7.2 Ky informacion duhet të jetë i publikuar në formë elektronike, në një gjuhë të qartë, pa pagesë, në format të aksesueshëm për të gjithë.

PJESA E TRETË

PROCEDURAT PËR TRAJTIMIN E ANKESAVE TË KLIENTËVE NDAJ TË LICENCUARVE

Neni 8

Pranimi dhe regjistrimi i ankesave në ERE

8.1 Çdo klient ka të drejtë të drejtohet me ankesë pranë ERE-s në këto raste:

8.1.1 Në rast se i licencuari, me anë të veprimeve ose mosveprimeve të ndërmarra nga ana e tij, ka shkelur dhe cenuar kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji elektrike dhe furnizimit të shërbimit universal, si dhe akteve të tjera që lidhen me furnizimin me energji elektrike dhe gaz natyror, të miratuara nga ERE.

8.1.2 Kur klienti ka përfunduar procedurën e trajtimit të ankesave pranë të licencuarit dhe nuk mbetet i kënaqur nga përgjigjja e dhënë nga i licencuari;

8.1.3 Në rast se ankuesi nuk merr një përgjigje nga i licencuari brenda afatit të parashikuar në rregulloren e të licencuarit “Për trajtimin e ankesave” dhe standardeve të cilësisë së shërbimit të miratuara nga ERE.

Rregullorja “Për trajtimin e ankesave” e të licencuarit do publikohet në një vend të dukshëm pranë çdo përfaqësie të tyre.

8.1.4 Çdo rrethanë tjetër që mund të përbëjë shkak për lindjen e një ankesë të klientit ndaj të licencuarve dhe nuk është parashikuar më sipër.

8.2 Çdo ankesë e paraqitur në ERE, regjistrohet në format elektronik apo të shkruar.

8.3 Regjistrimi duhet të përfshijë:

a) Një kod unik identifikues;

b) Datën e paraqitjes së ankesës, identitetin e parashtruesit të ankesës dhe detajet e kontaktit të tij;

c) Numrin i kontratës së furnizimit me energji elektrike apo gaz natyror;

d) Subjektin ndaj të cilit ankohet ankuesi;

e) Objektin e ankesës dhe një përmbledhje të saj;



f) Nëse klienti është ankuar më parë në ERE apo tek i licencuari, për të njëjtin objekt ankimi, për të cilin bëhet ankesa e re;

g) çdo informacion apo dokument tjetër që lidhet me shqyrtimin dhe trajtimin e ankesës.

8.4 ERE në të gjitha rastet do të pranojë një ankesë vetëm në rastet kur ankuesi paraqet informacionin minimal të përcaktuar më sipër.

8.5 Të gjitha komunikimet ndërmjet ERE-s dhe ankuesit lidhur me ankesën, do të regjistrohen duke respektuar kodin unik identifikues.

8.6 Pranimi dhe trajtimi i ankesave të klientëve dhe të të licencuarve nga ERE, do të jetë një shërbim i ofruar pa pagesë.

Neni 9

Trajtimi dhe zgjidhja e ankesave

9.1 Trajtimi dhe zgjidhja e ankesave nga ERE do të konsistojë në hetimin dhe verifikimin e të gjitha rrethanat dhe të dhënat lidhur me ankesën e regjistruar.

9.2 ERE, sipas rastit, do të dërgojë për verifikim ankesën pranë subjektit të ankimuar brenda 15 ditë ve kalendarike.

9.3 I licencuari është i detyruar të kthejë përgjigje për trajtimin e ankesës brenda 10 ditëve kalendarike, nga data e marrjes së shkresës. Në rast se kërkohet nga i licencuari më tepër kohë për trajtimin e ankesës, ky afat mund të zgjatet me 20 ditë të tjera kalendarike.

9.4 ERE, mund të kërkojë informacion shtesë nga ankuesi ose nga i licencuari ndaj të cilit paraqitet ankesa, brenda 10 ditëve kalendarike pas pranimit të ankesës.

9.5 ERE, pasi të ketë reregjistruar ankesën dhe pasi të ketë filluar trajtimin e saj, mund të vendosë se nuk ka juridiksion mbi çështjen.

9.6 Në çdo fazë të shqyrtimit të ankesës, nëse e çmon të arsyeshme ERE, mund të thërrasë palët në seancë dëgjimore. Palëve u jepet një afat jo më pak se 5 ditë kalendarike kohë për t'u paraqitur në seancë dëgjimore. Njoftimi për seancë dëgjimore përfshin çështjet që do të trajtohen në seancë dëgjimore.

9.7 Pas përfundimit të trajtimit të ankesës, ERE duhet të informojë ankuesin dhe të licencuarin ndaj të cilit është paraqitur ankesa, për veprimet e ndërmarra për të zgjidhur ankesën dhe për të shmangur problemin.

9.8 Në rastet kur ankesa rezulton e drejtë, ERE i komunikon të licencuarit, veprimet korrigjuese apo kompensuese, të cilat duhet të ndërmarrë ndaj klientit, në përputhje me “Kushtet e përgjithshme të shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë” dhe “Kushteve të përgjithshme të shërbimit të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, si dhe “Rregullores për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes dhe shitjes së energjisë elektrike”.

9.9 Veprimet e kërkuara nga ERE ndaj të licencuarit, për trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave të klientëve, janë të detyrueshme për të licencuarit, subjekt i ankimit.

9.10 Afati maksimal i trajtimit dhe i zgjidhjes së ankesave të furnizimit me energji elektrike është 30 ditë kalendarike nga regjistrimi i ankesës. Kjo periudhë mund të zgjatet deri në 30 ditë të tjera kalendarike, në rastet kur ERE-s i nevojitet informacion shtesë.

9.11 Afati maksimal i trajtimit dhe i zgjidhjes së ankesave të furnizimit me gaz natyror është 30 ditë kalendarike nga regjistrimi i ankesës. Kjo periudhë mund të zgjatet deri në 30 ditë të tjera kalendarike, në rastet kur ERE-s i nevojitet informacion shtesë.

Neni 10

Komunikimi i vendimit

Vendimi ose çdo veprim i ndërmarrë për trajtimin dhe zgjidhjen e ankesës, duhet t'i komunikohet ankuesit brenda 5 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit ose veprimit të ndërmarrë.

PJESA E KATËRT PROCEDURA PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE MES TË LICENCUARVE

Neni 11

Pranimi dhe regjistrimi i mosmarrëveshjeve në ERE

11.1 Çdo i licencuar, ka të drejtë të paraqesë me shkrim, pranë ERE-s, një kërkesë për shqyrtimin e një mosmarrëveshjeje, të lindur mes tij dhe një ose më shumë të licencuarit tjetër, në këto raste:

11.1.1 Në rast se nga ana e një tjetër të licencuarit, me anë të veprimeve ose mosveprimeve të ndërmarra nga ana e tij, ka shkelur dhe cenuar



kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji elektrike ose gaz natyror të miratuara nga ERE;

11.1.2 Në rastin kur të licencuarit dhe përdoruesit i refuzohet aksesin në rrjet;

11.1.3 Në rastin kur nuk është arritur marrëveshja për aksesin në rrjet dhe interkonjeksionin;

11.1.4 Çdo rrethanë tjetër që mund të përbëjë shkak për lindjen e një mosmarrëveshjeje midis të licencuarve dhe nuk është parashikuar më sipër.

11.2 Çdo kërkesë e paraqitur në ERE, për shqyrtimin e një mosmarrëveshjeje, duhet të regjistrohet në format elektronik apo të shkruar. Regjistrimi duhet të përfshijë:

a) Një kod unik identifikues;

b) Data e paraqitjes së kërkesës për shqyrtimin e mosmarrëveshjes;

c) Identiteti i parashtruesit të kërkesës dhe detajet e kontaktit të tij;

d) Objekti i kërkesës dhe një përmbledhje e saj;

e) Çdo informacion apo dokument tjetër që lidhet me shqyrtimin dhe trajtimin e ankesës.

11.3 ERE, në të gjitha rastet do të pranojë një kërkesë për shqyrtimin e një mosmarrëveshjeje, vetëm në rastet kur kërkuar paraqet informacion minimal të përcaktuar më sipër.

11.4 ERE, pasi të ketë pranuar kërkesën për shqyrtimin e mosmarrëveshjes dhe pasi të ketë filluar shqyrtimin e saj, mund të vendosë se nuk ka juridiksion mbi çështjen.

11.5 Të gjitha komunikimet ndërmjet ERE-s dhe të licencuarit lidhur me kërkesën e tij, do të regjistrohen duke respektuar kodin unik identifikues.

11.6 Pranimi dhe trajtimi i kërkesave të të licencuarve, për shqyrtimin e një mosmarrëveshjeje nga ERE, do të jetë një shërbim i ofruar pa pagesë.

Neni 12

Procedura e zgjidhjes së mosmarrëveshjes

ERE do të zhvillojë procedurë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, në këto faza:

12.1 Pranimi i mosmarrëveshjes

12.1.1 ERE e pranon kërkesën me shkrim për shqyrtimin e mosmarrëveshjes, kërkesë e cila përmban informacionin e kërkuar të përshkruar në nenin 11 të kësaj rregulloreje.

12.1.2 ERE do të vendosë nëse kërkesa për zgjidhjen e mosmarrëveshjes është në kompetencën e ERE-s për zgjidhje dhe do të

vlerësojë bazën ligjore për shqyrtimin e mosmarrëveshjes.

12.1.3 Afati maksimal për pranimin ose kundërshtimin e kërkesës është 15 ditë kalendarike nga data e depozitimit të njoftimit. Brenda këtij afati kohor, ERE do të kërkojë plotësimin e të gjithë informacionit të nevojshëm.

12.2 Seanca dëgjimore nga ERE

12.2.1 Përpara shprehjes së qëndrimit ose marrjes së vendimit, nëse e çmon të arsyeshme, ERE mund të thërrasë palët në seancë dëgjimore. Palëve u jepet një afat jo më pak se 5 ditë kalendarike kohë për t'u paraqitur në seancë dëgjimore. Njoftimi për seancë dëgjimore përfshin çështjet që do të trajtohen nga ERE-s në seancë dëgjimore.

12.2.2 Në seancë, palët në mosmarrëveshje mund të japin argument me gojë ose me shkrim dhe kanë të drejtë të përfaqësohen ligjërisht.

12.2.3 Në përfundim të seancës dëgjimore, ERE do të shprehë qëndrimin e saj, lidhur me mosmarrëveshjen, dhe nëse është e nevojshme, nëpërmjet vendimit të Bordit.

12.2.4 Bordi i ERE mund të shprehet me vendim nëse rrethanat e mosmarrëveshjes janë të njëjta dhe të përsëritura mes të njëjtave palë. Vendimi përfundimtar për zgjidhjen e mosmarrëveshjes do të miratohet nga Bordi i ERE-s dhe u njoftohet palëve sipas përcaktimeve në "Rregulloren e organizimit të ERE-s", dhe në "Kodin e Procedurave Administrative", të miratuar me ligjin nr. 44/2015.

12.2.5 Vendimi përfundimtar duhet të përmbajë të plota dhe të qarta arsytet për vendimin e Bordit të ERE-s.

12.2.6 ERE do të publikojë në faqen zyrtare të saj versionin publik të vendimit përfundimtar lidhur me mosmarrëveshjet, duke marrë parasysh detyrimin për mospublikimin e sekreteve tregtare të palëve.

12.3 Afati kohor për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

12.3.1 Afati maksimal i shqyrtimit dhe i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve për furnizimin/transmetimit me energji elektrike është 45 ditë kalendarike nga regjistrimi i të kërkesës. Kjo periudhë mund të zgjatet deri në 30 ditë të tjera kalendarike, në rastet kur ERE-s i nevojitet informacion shtesë.



12.3.2 Afati maksimal i shqyrtimit dhe i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të furnizimit dhe transmetimit të gazit natyror është 45 ditë kalendarike nga regjistrimi i kërkesës. Kjo periudhë mund të zgjatet deri në 30 ditë të tjera, në rastet kur ERE-s i nevojitet informacion shtesë.

Neni 13

Rishikimi i vendimit të bordit të ERE-s

Çdo palë e përfshirë në procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit lidhur me këtë procedurë, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. ERE do të shqyrtojë kërkesën në zbatim të parashikimeve të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s".

Neni 14

Publikimi i të dhënave lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe trajtimin e ankesave

ERE do të publikojë në faqen zyrtare të internetit, numrin e ankesave dhe mosmarrëveshjeve të paraqitura, objektin e tyre, masat dhe veprimet e ndërmarra për eliminimin e tyre.

PJESA E PESTË DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 15

Ankimimi

Kundër vendimit të Bordit të ERE-s mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike, nga data e publikimit të vendimit në Fletoren Zyrtare.

Neni 16

Rishikimi dhe ndryshimi i rregullave

Kjo rregullore është objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit të ERE-s

Neni 17

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga ana e Bordit të ERE-s.

VENDIM

Nr. 115, datë 8.7.2016

MBI PËRCAKTIMIN E FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË FUNDIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", dhe nenit 8, të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s" miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, të Bordit të ERE-s, Bordin i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 8.7.2016, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit "Mbi përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

1. Me vendimin nr. 449, datë 15.6.2016, Këshilli i Ministrave ka miratuar "Kushtet dhe procedurat për caktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike".

2. Në pjesën III, të VKM-së nr. 449, datë 15.6.2016, Këshilli i Ministrave ka miratuar "Kushtet dhe procedurat për caktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike", parashikohet se: "Deri në përzgjedhjen e furnizuesit të mundësisë së fundit, sipas këtij vendimi, ERE cakton përkohësisht furnizuesin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për të kryer detyrat e furnizuesit të mundësisë së fundit".

3. Me VKM nr. 244, datë 30.3.2016 janë miratuar "Kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike".

4. Në VKM nr. 244, datë 30.3.2016 është parashikuar se: "Detyrimi i shërbimit publik përfshin ndër të tjera KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., ku kjo e fundit do të sigurojë blerjen e energjisë elektrike për qëllime të shërbimit universal nga KESH sh.a. ".

Për gjithë sa më sipër, Bordin i ERE-s

VENDOSI:

1. Të përcaktojë përkohësisht OSHEE sh.a. në cilësinë e furnizuesit të shërbimit universal, për të kryer detyrat e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike, nga data 1 korrik 2016 deri në 31.12.2016.



2. Në rastet kur klienti nuk arrin të sigurojë furnizues në treg për shkak të pamundësisë objektive të operatorëve të sistemit, furnizimi si mundësi e fundit kryhet në të njëjtat kushte me shërbimin universal të furnizimit, sipas parashikimeve të vendimit të Këshilli i Ministrave nr. 449, datë 15.6.2016.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 116, datë 8.7.2016

**MBI KËRKESËN E SHOQATËS
SHQIPTARE TË ENERGJISË SË
RINOVUESHME PËR RISHIKIMIN E
VENDIMIT NR. 101, DATË 23.6.2016 TË
BORDIT TË ERE-s, “MBI MIRATIMIN E
DISA NDRYSHIMEVE NË MODELIN E
KONTRATËS SË SHITBLERJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET
KESH SHA (FPSH) DHE PRODHUESVE
TË VEGJËL TË ENERGJISË (PVE)
MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 80,
DATË 23.10.2009, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenit 16, pika 4, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016 të Bordit të ERE-s, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 8.7.2016, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, mbi kërkesën e Shoqatës Shqiptare të Energjisë së Rinovueshme, AREA, për rishikimin e vendimit nr. 101, datë 23.6.2016 të Bordit të ERE-s, “Mbi miratimin e disa ndryshimeve në modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. (FPSH) dhe prodhuesve të vegjël të energjisë (PVE) miratuar me vendimin nr. 80, datë 23.10.2009, të ndryshuar”,

konstatoi se:

- Shoqata AREA nuk përfaqëson palë interesi, të legjitimuar për të kërkuar rishikimin e një vendimi, akt normativ, të Bordit të ERE-s.

- Nuk është provuar se cilat janë subjektet e licencuara nga ERE, interesat e të cilave prezumohet se janë cenuar nga vendimmarrja e ERE-s.

- Nuk është paraqitur asnjë provë për të mbështetur kërkesën për rishikimin e vendimit nr. 101, datë 23.6.2016 të Bordit të ERE-s “Mbi miratimin e disa ndryshimeve në modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. (FPSH) dhe prodhuesve të vegjël të energjisë (PVE) miratuar me vendimin nr. 80, datë 23.10.2009, të ndryshuar”.

- ERE ka detyrimin të të zbatojë parashikimet e legjislacionit në fuqi, përfshirë ligjin 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ligjin 138/2013, “Për burimet e energjisë së rinovueshme” dhe VKM-së 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rrëzojë kërkesën e Shoqatës Shqiptare të Energjisë së Rinovueshme, AREA, për rishikimin e vendimit nr. 101, datë 23.6.2016 të Bordit të ERE-s “Mbi miratimin e disa ndryshimeve në modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. (FPSH) dhe Prodhuesve të Vegjël të Energjisë (PVE) miratuar me vendimin nr. 80, datë 23.10.2009, të ndryshuar”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 308 lekë